



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 691 Akti

Nr. 724 Vendimi
Tiranë, më 13.12.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 11.12.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arben Agovi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Arben Agovi, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Agovi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në dhjetor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Arben Agovi do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arben Agovi sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 23.11.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arben Agovi; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit më 7.12.2023.
8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Arben Agovi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit Arben Agovi u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 7.12.2023.

10. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 11.12.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

11. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Arben Agovi kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Z. Arben Agovi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

14. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

14.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

14.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

¹ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit

kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin Arben Agovi:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

18. Z. Arben Agovi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë: (i) para fillimit të detyrës, vitit 2003; (ii) periodike/vjetore për vitet 2004 – 2016; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; provat shkrese/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

20. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Arben Agovi, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi ***, datë 26.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2004 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditetet – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

21. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Arben Agovi ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Automjet tip “**”**

1.1 Subjekti ka deklaruar pasurinë automjet tip “****”, me targë AA *** NH, përfituar me kontratë shitjeje datë 6.5.2013 dhe regjistruar në DRSHTRR-në Laç më 3.2.2016. Vlera: 270,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

1.2 Lidhur me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhurat gjendje cash, para shqiptare (lekë), ku në kohën e blerjes së këtij automjeti disponoheshin nga unë, përveç kursimeve që vinin nga paga, edhe gjendje cash, si pasojë e shitjes së automjetit me targë AA*** CG, sipas kontratës së shitjes datë 1.10.2012, me vlerë 400,000 lekë”*.

Hetimi i Komisionit

1.3 DPSHTRR-ja ka konfirmuar² se automjeti me targë AA *** NH është në pronësi të shtetasit Arben Agovi.

1.4 Rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.5.2013, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “****”, me nr. shasie ***, vit prodhimi 1999, në vlerën 270,000 lekë. Palë shitëse e pasurisë automjet është shtetasi R.Q, i cili duket se e ka blerë këtë automjet në vlerën 800 euro, në datën 21.1.2013.

² Shihni shkresat e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 14.8.2017 dhe nr. *** prot., datë 30.8.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

1.5 Për këtë pasuri subjekti është pajisur me lejen e qarkullimit nr. *** dhe certifikatën e kontrollit teknik nga DPSHTRR-ja, datë 3.2.2016, konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2021.

1.6 Certifikata e pronësisë së automjetit me targë AA *** NH është lëshuar në datën 3.2.2016, në emër të subjektit të rivlerësimit.

Lidhur me vlerën dhe burimin e blerjes së pasurisë automjet në vitin 2013

1.7 Vlera e blerjes së kësaj pasurie rezultoi sipas kontratës së shitblerjes³ në shumën 270,000 lekë.

1.8 Lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë automjet, subjekti ka deklaruar kursimet *cash*, përfshirë këtu edhe të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm.

1.9 Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *“Kursimet cash nga paga dhe pensioni i pleqërisë së nënës në shumën 870,000 lekë. Nga këto kursime është blerë një automjet në datën 6.5.2013, tek noteri publik A. K., Shijak, në shumën 270,000 lekë”*.

1.10 Bazuar në praktikën e dërguar nga DPSHTRR-ja⁴ rezultoi se me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.10.2012, subjekti i rivlerësimit e ka shitur automjetin me targë AA *** CG, në vlerën 400,000 lekë. Pala blerëse e kësaj pasurie është shtetasi Sh.H. Këtë pasuri automjet subjekti i rivlerësimit e ka blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.10.2011, nga shtetasi A.K në vlerën 5,700 euro. Shtetasi A. K. duket se e ka blerë këtë pasuri në vitin 2011 në vlerën 1,000 euro dhe ka paguar detyrimet tatimore në shumën 58,617 lekë.

1.11 Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: *“Kursime cash nga paga për vitin 2012 + shpërblime nga Prokuroria e Përgjithshme, pensioni i pleqërisë së nënës dhe nga shitja e automjetit AA *** CG në vlerën 600,000 lekë”*.

1.12 Subjekti e ka deklaruar blerjen e automjetit me targë AA *** CG edhe në DPV-në e vitit 2011, në vlerën 5,700 euro. Burimi i krijimit është deklaruar nga të ardhurat familjare në vite.

1.13 Lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi me palët shitëse të automjeteve, R. Q. dhe A. K., u pyet subjekti i rivlerësimit, i cili, sipas pyetësorit nr. ***, ktheu përgjigje: *“Deklaroj në përgjegjësinë time se gjatë kohës së ushtrimit të detyrës sime si prokuror, duke nisur nga data 16.3.2001, nuk kam pasur në objekt kallëzimi, hetimi, si penal ashtu edhe pasuror, çështje, ku subjekte të kenë qenë shtetasit A.D.K në cilësinë e shitësit, sipas kontratës së shitblerjes (pasuri e paluajtshme automjet) datë 22.10.2011 dhe R.I.Q, në cilësinë e shitësit sipas kontratës së shitblerjes 6.5.2013”*.

1.14 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 7.9.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer verifikime, hetime apo të ketë ushtruar ndjekje penale ndaj palëve shitëse të pasurive automjet, A.K dhe R.Q.

³ Shihni kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.5.2013, në dosjen e Komisionit.

⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2021, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

Analiza financiare

1.15 Komisioni vlerësoi mundësitë financiare të subjektit lidhur me blerjen e pasurisë automjet tip “****”, me targë AA *** CG, në vitin 2011, në vlerën 5,700 euro (798,000 lekë me kurs këmbimi 1 euro = 140 lekë sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. ***). Nisur nga fakti se burim për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat e krijuara *cash* nga vitet e mëparshme, Komisioni konstatoi se subjekti në fillim të vitit 2011 ka pasur gjendje progresive të këtyre kursimeve në vlerën 955,000 lekë. Kjo vlerë kursimesh është e mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “****”, me targë AA *** CG, në vlerën 5,700 euro, në vitin 2011.

1.16 Nga rezultati pozitiv i viteve 2008 – 2010 (vite të krijimit të gjendjes *cash*), subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj shume.

1.17 Sa më sipër, rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurisë automjet tip “****” në vitin 2011 dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, prandaj edhe të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në vitin 2012 në shumën 400,000 lekë konsiderohen të ligjshme dhe, si të tilla, janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2012.

1.18 Lidhur me mundësinë financiare për blerjen e pasurisë automjet tip “****”, me targë AA*** NH, në vitin 2013, Komisioni u bazua në deklarimin e subjektit, sipas të cilit, kjo pasuri është blerë me të ardhurat *cash*. Komisioni konstaton se kursimet *cash* në fund të vitit 2012, në të cilat përfshihen edhe të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm tip “****” në shumën 400,000 lekë arrijnë në një vlerë progresive prej 957,000 lekësh. Nga rezultati pozitiv i viteve 2008 – 2012 (vite të krijimit të gjendjes *cash*) subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj shume, e cila është e mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “****” në shumën 270,000 lekë, në vitin 2013.

1.19 Nga sa më sipër, rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme edhe për krijimin e pasurisë automjet tip “****” në vitin 2013, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

1.20 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se nuk u konstatuan problematika për pasurinë automjet të blerë nga subjekti dhe se ai ka bërë deklaram të saktë dhe ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë automjet me targë AA *** NH.

2. Para cash

2.1 Subjekti ka deklaruar para *cash* në vlerën 1,000,000 lekë. Si burim krijimi janë deklaruar kursimet ndër vite prej të ardhurave nga paga, ku gjendja *cash* deri në datën 31.12.2016 arrinte në shumën 1,300,000 lekë. Nga kjo shumë është zbritur pagesa e av/mbrojtës për përfaqësimin në gjyq civil (dëmshpërblim aksidenti) prej 300,000 lekësh, pagesë e datës 19.1.2017. Pjesa takuese: 100%.

2.2 Subjekti për të provuar deklarimin e tij ka paraqitur *faturë derdhjeje në BKT të shumës 300,000 lekë, në datën 19.1.2017. Derdhur në llogarinë e z. K. T. (person fizik) për përfaqësim në gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, çështje civile.*

2.3 Rezultoi se për herë të parë subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në DPV-në e vitit 2008 si kursime nga paga si prokuror gjatë vitit të deklarimit jashtë banke në shumën 250,000 lekë dhe kursime nga pensioni që ka përfituar nëna jashtë banke në shumën 55,000 lekë.

2.4 Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *“Shtesë në vlerë në lekë, kursimet nga paga vjetore si prokuror 250,000 lekë. Shtesë në vlerë lekë nga pensioni i nënës 150,000 lekë. Gjithsej shuma 400,000 lekë”*.

2.5 Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura nga paga si prokuror, ka shtesë në shumën 250,000 lekë”*.

2.6 Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura nga paga për vitin 2011, 1,102,087 lekë – shuma 200,000 lekë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar blerje automjeti në vlerën 5,700 euro, me burim të ardhurat familjare në vite”*.

2.7 Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: *“Kursime cash nga paga për vitin 2012 + shpërblimi nga Prok. Përgjith., nga pensioni i pleqërisë së nënës dhe nga shitja e automjetit tip “***”, me targë AA *** CG, vlera 600,000 lekë”*.

2.8 Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *“Kursime cash nga paga ime për vitin 2013 dhe pensioni i nënës 870,000 lekë. Nga këto kursime është blerë automjeti tip “***” në datën 6.5.2013, në shumën 270,000 lekë”*.

2.9 Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *“Kursime nga paga personale. Shtesë nga deklarimi i vitit të kaluar +300,000 lekë”*.

2.10 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Kursimet nga paga personale në vite të pasqyruara këto edhe në deklaratat e mëparshme ku shuma e parave cash është deklaruar dhe në deklarimin e dhënë para inspektorit të ILDKPKI-së, ku shuma e parave deri në fundin e vitit 2014 ka qenë 900,000 lekë. Shtesa prej 200,000 lekësh sipas kolonës ngjitur është si pasojë e ruajtjes nga të ardhurat nga paga personale për vitin 2015 – shtesë nga deklarimi i vitit të kaluar + 200,000 lekë, pra gjithsej 1,100,000 lekë (cash)”*.

2.11 Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *“Para cash nga kursimet, sikurse është deklaruar edhe më parë, kryesisht nga paga si prokuror. 1,300,000 lekë cash kursime, ku këtu përfshihet edhe shtesa për këtë vit deklarimi pra për vitin 2016, shuma 200,000 lekë nga kursimet e pagës”*.

2.12 Lidhur me saktësimet mbi ndryshimet e gjendjes cash ndër vite u pyet subjekti i rivlerësimit, i cili ktheu përgjigje sipas pyetësorit nr. ***⁵.

2.13 Gjithashtu, lidhur me deklaratimet e gjendjes cash dhe ndryshimet e saj ndër vite, u kërkuan procesverbalet e mbajtura pranë ILDKPKI-së⁶.

2.14 Përgjigjet e subjektit dhe deklaratimet në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së nuk përkojnë plotësisht me deklaratimet periodike vjetore (ndryshimet e likuiditeteve cash). Komisioni konstatoi mospërputhje të deklaratimeve të subjektit lidhur me ndryshimet e gjendjes cash ndër vite dhe pasaktësi në deklarime.

2.15 Viti 2013 konstatohet si vit më problematik lidhur me ndryshimet e gjendjes cash, për shkak se subjekti:

⁵ Shihni përgjigjet e detajuara të subjektit sipas pyetësorit nr. *** në dosjen e Komisionit.

⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2023, nga ILDKPKI-ja lidhur me procesverbalin e mbajtur në datën 8.1.2016 “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurisë”.

- Në DPV-në e vitit 2013 ka deklaruar: *“Kursime cash paga ime për vitin 2013 dhe pensioni i nënës 870,000 lekë. Nga këto kursime është blerë automjeti tip “****” më 6.5.2013, në shumën 270,000 lekë”*.
- Në përgjigje të pyetësorit ka deklaruar: *“Në vitin 2013 është blerë automjeti tip “****” në shumën 270,000 lekë; kursime cash nga paga vjetore e funksionit të prokurorit në shumën 53,000 lekë. Gjendja e kursimeve cash në shtëpi në fund të vitit 2013 llogaritet në shumën 600,000 lekë”*.
- Sipas procesverbalit të mbajtur pranë ILDKPKI-së: *“...në DPV-në e vitit 2013 kam deklaruar gjendjen cash që kam pasur nga kursimet në vite, pra 870,000 lekë nga të cilat 270,000 lekë janë përdorur për blerje automjeti në maj 2013 dhe gjendja cash që disponoja në dhjetor 2013 është 600,000 lekë”*.

2.16 Nisur nga pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet e subjektit lidhur me gjendjen *cash* dhe ndryshimet (shtesa dhe pakësime) ndër vite, Komisioni, në analizën financiare (për vitet 2008 – 2016) mori si referencë deklaratimet e bëra nga subjekti në deklaratat periodike vjetore të paraqitura pranë ILDKPKI-së.

2.17 Lidhur me mundësinë e subjektit dhe bashkëshortes për krijimin e kursimeve *cash* ndër vite, referojuni analizës financiare të viteve 2008 – 2016 në pikën 10 të këtij vendimi.

2.18 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se ka pasaktësi në deklaratimet e subjektit lidhur me gjendjen *cash* dhe ndryshimet ndër vite, e cila ka sjellë një pamundësi financiare⁷ në vitin 2013 në shumën -515,160 lekë.

2.19 Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.20 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar: *“Gjendja cash e disponueshme në dhjetor të vitit 2013 është 600,000 lekë (shumë parash gjendje në vite e ardhur si rrjedhojë e diferencës mes kursimeve gjendje dhe vlerës së blerjes së automjetit, në shumën 270,000 lekë). Gjendja cash në fund të vitit 2010 ka qenë në shumën 955,000 lekë. Kursimet nga paga vjetore si prokuror në vitin 2011 kanë qenë në shumën 200,000 lekë, pra në total 1,155,000 lekë. Në vitin 2011 është blerë automjeti tip “****”, në shumën 5,700 euro (798,000 lekë). Duke zbritur këtë shumë të blerjes së automjetit nga shuma 1,155,000 lekë, rezultati llogaritet në shumën 357,000 lekë.*

Ndërsa në tetor të vitit 2011 është bërë një dërgesë parash në shumën 1,000 euro në drejtim të vëllait të bashkëshortes sime, shtetasit K. Gj. Gj. Ndaj, nga shuma 357,000 lekë është zbritur shuma 140,000 lekë (1,000 euro) dhe gjendja cash e parave në fund të vitit 2011 është në shumën 217,000 lekë dhe jo 357,000 lekë.

Për vitin 2012 kursimet cash janë në shumën 600,000 lekë dhe bashkë me likuiditetin në fund të vitit 2011 (217,000 lekë) përbën gjendjen cash të parave në shumën 817,000 lekë.

⁷ Lidhur me gjetjet dhe reflektimin e ndryshimeve të gjendjes *cash* referojuni analizës financiare në pikën 10 të këtij vendimi.

*Ndërkohë në vitin 2013 është blerë automjeti tip “***”, të cilin e posedoj dhe aktualisht, në shumën 270,000 lekë, dhe kursimet cash për vitin 2013 kanë qenë gjendje në shumën 53,000 lekë, duke u llogaritur pa blerjen e automjetit prej 270,000 lekësh. Shuma prej 817,000 lekësh, gjendja cash në fund të vitit 2012 bashkë me kursimet për vitin 2013 prej 53,000 lekësh, bëhen gjithsej 870,000 lekë. Dhe duke qenë se është blerë automjeti në shumën 270,000 lekë, atëherë diferenca përbën gjendje cash për vitin 2013 në shumën 600,000 lekë”.*

2.21 Sa më lart, subjekti ka pretenduar se nuk ka bërë pasaktësi në deklarime dhe nuk gjendet në pamundësi financiare në vitin 2013 në shumën -515,160 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

2.22 Referuar sqarimeve të subjektit në lidhje me gjendjen *cash* ndër vite dhe deklarimit të bërë në deklaratat periodike, Komisioni nuk mori parasysh pretendimin e tij në lidhje me pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2011 për shkak të një dërgese prej 1,000 euro, bërë nga bashkëshortja tek vëllai i saj K.Gj. Arsyeja është sepse subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore as shpenzimin (1,000 euro) dhe as pakësimin e kursimeve *cash*.

2.23 Referuar pretendimit të subjektit se në vitin 2012 kishte gjendje *cash* në vlerën 817,000 lekë (217,000 + 600,000), Komisioni vlerësoi se në analizën financiare gjendja *cash* sipas deklarimeve të subjektit ka qenë 957,000 lekë (357,000 + 600,000). Këtu ndryshon vlerësimi i Komisionit nga pretendimi i subjektit për shkak të mospërputhjes së gjendjes *cash* të pretenduar që në vitin 2011.

2.24 Sa i përket vitit 2013, Komisioni nuk pranoi qëndrimin e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit në krahasim me atë të deklarimit periodik të vitit. Pretendimi se në vitin 2013 kishte gjendje *cash* në vlerën 600,000 lekë (817,000 + 53,000 – 270,000) nuk përputhet me deklarimin e bërë në deklarimin periodik të vitit 2013, në të cilin deklarohet: “*Kursime cash paga ime për vitin 2013, pensioni i pleqërisë së nënës sime – 870,000 lekë. Është blerë nga kursimet e lartpërmendura një automjet tip “***” autoveturë, sipas kontratës së datës 6.5.2013 – 270,000 lekë*”. Deklarimi i bërë nga subjekti në vitin 2013 i referohet kursimeve të krijuara në vitin 2013, në vlerën 870,000 lekë dhe jo gjendjes së mëparshme të kursimeve. Prandaj, Komisioni vlerësoi gjendjen *cash* në analizën financiare në vlerën 1,557,000 lekë (957,000 + 870,000 – 270,000).

2.25 Në analizën financiare, përfundimisht, ndryshimet e kursimeve *cash* janë bërë sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore përkatëse të paraqitura pranë ILDKPKI-së.

3. Apartament banimi në rrugën “*”**

3.1 Subjekti ka deklaruar pasurinë apartament në rrugën “***”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë, ku banon. Kjo pasuri është privatizuar në vitin 1993 nga babai, i ndjeri T.A nga N.K.Banesa nr. **, Tiranë, e cila u ka bërë shitje tre anëtarëve të familjes dhe konkretisht, T.A, L.A (nëna) dhe A.A (motra e martuar më 20.9.1993). Për këtë është lidhur kontratë në datën 7.7.1994.

3.2 Subjekti ka deklaruar edhe se ky apartament nuk është në pronësinë e tij, por nëna ka 1/3. Vlera e asetit: 13.616 lekë. Nëna posedon 1/3.

Hetimi i Komisionit

3.3 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe në DPV (2004 – 2016), si adresë ku është regjistruar në gjendjen civile.

3.4 Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 23.1.2017, të ish-ZVRPP-së Tiranë, konstatohet se në emër të shtetases L. A (nëna e subjektit) figuron i regjistruar apartamenti me sip. 70.5 m², z. k. ***, v. ***, f. ***, rruga “****”, 1/3 pjesë.

3.5 Kjo pasuri apartament me sip. 70.5 m², në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, kati përdhe, rezultoi e përfituar me kontratë për privatizim banese datë 13.8.1993. Vlera e asetit sipas kontratës është 13,616 lekë. Kontratë e shitblerjes është lidhur midis N. K.B nr. ***, Tiranë dhe si palë blerëse T.A, L.A dhe A.A.

3.6 Ish-ZVRPP-ja Tiranë⁸ konfirmon pasurinë apartament me sip. 70.5 m², ndodhur në z. k. ***, v. ***, f. ***, në pronësi të shtetases L. A, në bashkëpronësi me të tjerë. Kartela e pasurisë së paluajtshme ka nr. pasurie ***, regjistruar më 13.4.1995. Shuma e paguar nga blerësit është 13,616 lekë, shoqëruar me faturë pagese datë 16.8.1993, në emër të shtetasit T. A.

3.7 Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003⁹, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të përfituar me privatizim në emër të babait, i cili ka ndërruar jetë më 11.1.2003 dhe nga ana e familjes nuk është kërkuar çelja e trashëgimisë. Në deklaratat periodike në vazhdim (2004 – 2016) subjekti e ka deklaruar këtë pasuri si adresë banimi.

3.8 Kjo pasuri nuk figuron në emër të subjektit, por 1/3 e saj rezultoi në emër të personit të lidhur që është nëna e tij (L.A) dhe e përfituar në vitin 1994 me kontratë në mbështetje të procedurave të privatizimit nga familja e origjinës së subjektit.

3.9 Komisioni e pyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë pasuri apartament të deklaruar si adresë në gjendjen civile dhe adresë banimi ndër vite. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti deklaroi: *“Apartament në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë, është adresa ime në lidhje me të dhënat e mia në Gjendjen Civile, kjo edhe aktualisht, duke e kuptuar në atë kohë, pra vitin 2003, adresë banimi, adresë zyrtare. Njëra dhomë e kësaj pasurie me sip. 15.9 m², është dhënë me qira për periudhën nëntor 2001 – 2005. Gati tri javë më pas, më 6.12.2001, është lidhur kontrata e blerjes së apartamentit në pallatin nr. ***, shk. ***, ap. ***, kati i ***, në rrugën “****”, Tiranë.*

*Apartamenti në pallatin nr. ***, shk. ***, ap. ***, kati i ***, në rrugën “****”, Tiranë, ka qenë dhe është i regjistruar edhe sot e kësaj dite, që nga data 20.12.2001, data e lëshimit të certifikatës për vërtetim pronësie, në emër të babait tim T. A (vdekur më 11.1.2003) dhe ende nuk është bërë çelja e trashëgimisë ligjore”.*

3.10 Për këtë apartament nëna e subjektit ka nënshkruar kontratë qiraje për periudhën nëntor 2001 – 2005, të sjella në përgjigje të pyetësorit nr. ***. Për të ardhurat nga kjo marrëdhënie qiraje subjekti ka sjellë edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga DRT-ja Tiranë, i cili vërteton pagesën e detyrimit të tatimit në burim për kontratë qiraje për periudhën në fjalë. Këto të ardhura janë trajtuar në pikën 7 të këtij vendimi.

⁸ Shihni shkresën e ZVRPP-së dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2018, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Shihni deklarinimin e subjektit në deklaratën e vitit 2003 në dosjen e ILDKPKI-së.

3.11 Rezultoi se subjekti është përfitues i kësaj pasurie si trashëgimtar (trashëgimi nga pjesa e babait), por që nuk ka bërë veprime për çeljen e trashëgimisë dhe regjistrimin e pjesës së tij takuese për këtë pasuri apartament.

3.12 Në përfundim të hetimit Komisioni arriti në konkluzionin se nuk u konstatuan problematika për këtë pasuri, për sa ajo është krijuar nga familja e origjinës së subjektit në vitin 1993 me anë të privatizimit.

4. Apartament banimi në rrugën “**”**

4.1 Subjekti ka deklaruar apartament banimi me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***. Adresa e pasurisë në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, k. ***, Tiranë, me sip. 47.3 m²; certifikatë lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë në datën 20.12.2001, në vlerën 1,900,000 lekë (e disponon nëna L.A).

4.2 Subjekti ka deklaruar: *“Ky apartament është blerë nga babai, i ndjeri T.A, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2001, me shitës K. M. Nuk është bërë çelja e dëshmisë së trashëgimisë. Ky apartament është blerë me të ardhurat e përfituara nga shitja e objekt pasurisë, e regjistruar në ZVRPP Tiranë në nr. Regj. hipotekor ***, e ndodhur në z. k. ***, pasuri me nr. ***, me sip. 69.7 m², me adresë Njësia Nr. ***, në rrugën “****” dhe një truall me sip. 69.7 m². Origjina e kësaj prone është nr. hipotekor ***, datë 14.4.1992 (privatizimi i objekteve tregtare të ish-NTI Tiranë në vitin 1992). Palë në këtë kontratë janë nëna ime L.A, në cilësinë e shitësit, dhe blerës G dhe A. S, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2002, ku çmimi i shitjes ishte 1,900,000 lekë dhe i dhënë më parë jashtë zyrës noteriale, pra i njëjtë me çmimin e blerjes së apartamentit nga babai im T.A, sipas kontratës së lartpërmendur”.*

Hetimi i Komisionit

4.3 Subjekti, bashkëlidhur deklaratës *Vetting* të dorëzuar në ILDKPKI, ka paraqitur një certifikatë për vërtetim pronësie mbi apartamentin e banimit me nr. pasurie ***, rruga “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, me sip. 47.3 m², në emër të shtetasit T.A (babai i subjektit), lëshuar më 20.12.2001.

4.4 Rezultoi se kjo pasuri është blerë nga babai i subjektit me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2001, me palë shitëse K.M. Vlera e blerjes së kësaj pasurie apartament sipas kontratës është 1,900,000 lekë. Sipas kontratës, shuma 1,900,000 lekë është likuiduar nga palët jashtë zyrës noteriale.

4.5 Këtë pasuri apartament subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003¹⁰. Sipas kësaj deklaratë kjo pasuri e paluajjtshme është përfituar me kontratë shitblerjeje të vitit 2001 dhe hipotekuar në vitin 2002 nga babai i subjektit, i cili ka ndërruar jetë më 11.1.2003 dhe nga ana e familjes nuk është kërkuar çelja e trashëgimisë. Në deklaratën e vitit 2003, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e kësaj pasurie *“Kursimet familjare të prindërve si pagë e punës së tyre”.*

4.6 Deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* lidhur me burimin e krijimit (nga të ardhurat e përfituara nga shitja e objekt pasuri e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë) duket se nuk përkon me deklaratën e vitit 2003 (nga kursimet familjare nga paga e prindërve).

¹⁰ Shihni deklarinimin e subjektit në deklaratën e vitit 2003 në dosjen e ILDKPKI-së.

4.7 Ish-ZVRPP-ja Tiranë¹¹ konfirmon se apartamenti me sip. 47.3 m², nr. pasurie ***, vol.***, f. ***, është në pronësi të shtetasit T.A. Për këtë është lëshuar edhe kartela e pasurisë së paluajtshme me nr. pasurie ***, si pasuri e përfutur me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2001.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

4.8 Komisioni hetoi lidhur me burimin e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* për blerjen e kësaj pasurie apartament nga babai i tij në vitin 2001 (subjekti ka deklaruar se burim janë të ardhurat e përfutura nga shitja e objekt pasuri e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në nr. regj. hipotekor ***, e ndodhur në z. k. ***, pasuri me nr. ***, me sip. 69.7 m², me adresë Njësia Nr. ***, në rrugën “****” dhe një truall me sip. 69.7 m²).

4.9 Rezultoi se me anë të kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2002, nëna e subjektit L.A ka shitur pasurinë nr. ***, me sip. 69.7 m², me adresë Njësia Nr. ***, në rrugën “****”, si dhe një truall me sip. 69.7 m², në shumën 1,900,000 lekë. Pala blerëse rezultuan shtetasit G. S. dhe A. S. Në emër të nënës së subjektit është lëshuar edhe vërtetimi i pronësisë nga dokumenti hipotekor nr. ***, z. k. ***, datë 21.1.1997.

4.10 Kjo pasuri njësi me sip. 69.7 m², e shitur nga nëna e subjektit, është përfutur me anë të kontratës së shitjes datë 31.3.1992, në vlerën 44,117 lekë. Gjithashtu, me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.1.1997, të lidhur midis AKP-së si palë shitëse dhe shtetas L.A, është blerë edhe trualli me sip. 69.7 m² në shumën 27,880 lekë.

4.11 Komisioni konstatoi se pasuria njësi dhe truall është shitur nga nëna e subjektit në datën 11.1.2002, kurse pasuria apartament është blerë nga babai i subjektit më 6.12.2001 (datë kur është likuiduar edhe shuma sipas kontratës). Pra, nga ky konstatim duket se të ardhurat e pretenduara nga shitja e njësisë dhe truallit nuk kanë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament.

4.12 Lidhur me këtë konstatim për mospërputhjen e datës së kontratës së shitjes së njësisë dhe truallit, e cila rezultoi pas blerjes së pasurisë apartament dhe mospërputhjen e burimit sipas deklaratës së vitit 2003 me deklaratën *Vetting* është pyetur subjekti i rivlerësimit.

4.13 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti deklaroi¹²: “Nëna ime L.A ka punuar në profesionin shitëse, pranë ish-N.T Tiranë dhe në fund pranë ish-***, në rrugën “****”, Tiranë, ka përfutur Njësine nr. ***, si pasojë e privatizimit të objekteve, ndërkohë që në datën 10.1.1997 është bërë blerja e truallit me palë shitëse AKP, dega Tiranë.

*Kjo njësi e privatizuar fillimisht bashkë me truallin që i korrespondonte është shitur nga nëna ime L.A shtetasve G dhe A.S, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2002, ndërkohë që paratë e përfutura si pasojë e shitjes së objektit, të dhëna përpara lidhjes së kontratës në fjalë, janë përdorur nga prindërit e mi për blerjen e apartamentit në pallatin nr. ***, shk. ***, ap. ***, kati ***, rruga “****”, Tiranë.*

Ky objekt ishte pronë e nënës sime, e regjistruar në emër të saj, dhe paratë nga shitja i kam konsideruar si të ardhura të saj, pra të nënës sime, prindërve të mi”.

4.14 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm dhe provojë se si burim për blerjen e pasurisë apartament më 20.12.2001,

¹¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2018, të ish-ZVRPP Tiranë, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Shihni përgjigjen e plotë të subjektit dërguar sipas pyetësorit nr. *** në dosjen e Komisionit.

kanë shërbyer të ardhurat në vlerën 1,900,000 lekë, të përfituara nga shitja e pasurisë së nënës së subjektit më 11.1.2002.

4.15 Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.16 Ashtu si në përgjigje pyetësori, edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me apartamentin e banimit të blerë në vlerën 1,900,000 lekë, në datën 20.12.2001. Sipas subjektit, kjo pasuri ka si burim të ardhurat nga shitja e objektit dhe truallit në emër të nënës së tij, në datën 11.1.2002, duke deklaruar: *“Duke qenë se nëna ime ndodhej në kushte mirëbesimi reciprok me shtetasin G.S, pasi janë siguruar paratë si pasojë e marrëveshjes për shitjen e dyqanit dhe truallit që ishin në pronësi të nënës sime (objekt i privatizuar dhe truall i blerë sipas shpjegimeve në pyetësozin nr. ***), këto para i janë dhënë shitësit të apartamentit për t’u formalizuar shitblerja përmes kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2001. Ky shpjegim¹³ është dhënë edhe nga ana e shtetasit G.S dhe bashkëshortja e tij përmes deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.9.2023”.*

Vlerësimi i Komisionit

4.17 Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit në lidhje me transaksionet e kryera nga prindërit e tij, blerja e më pas shitja e pasurisë apartament, kanë si burim të ardhurat nga shitja e objektit dhe truallit në emër të nënës në datën 11.1.2002. Këto para duken se janë marrë në mirëbesim (paradhënie) nga shitja e pasurisë së nënës që në dhjetor të vitit 2001, ku më pas janë përdorur për blerjen e apartamentit tjetër me të njëjtën vlerë në një periudhë të shkurtër kohore.

4.18 Ndërsa në lidhje me mospërputhjen e deklaramit të burimit të blerjes ndërmjet deklaratës *Vetting* me atë të DPV-së vitit 2003, kjo pasaktësi nuk çon peshë në vlerësimin përfundimtar të krijimit të pasurisë, për sa kohë kjo pasaktësi nuk shoqërohet me dyshimin e fshehjes së vërtetë të burimit të krijimit të saj nga ana e subjektit të rivlerësimit.

4.19 Në përfundim, Komisioni konkludoi se kjo pasuri është krijuar me burime nga prindërit e subjektit dhe ndaj subjektit nuk u adresuan problematika, të cilat të mund të ndikonin në vlerësimin përfundimtar të tij.

5. Depozitë bankare

5.1 Subjekti ka deklaruar se djalit të tij (T.A.A), i datëlindjes 22.12.2009, i është hapur një llogari depozite nga Bashkia Tiranë (fëmijët e lindur në vitin 2009) më 15.6.2010, në Raiffeisen Bank, në shumën 5,000 lekë e, tani, 5,002.79 lekë. Pjesa takuese: 100% djali.

5.2 Bazuar në përgjigjen e Raiffeisen Bank datë 20.1.2017, rezultoi llogari e hapur në datën 21.6.2010, në vlerën 5,000 lekë, me gjendje në datën 30.12.2016, në shumën 5,002.79 lekë.

5.3 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2017, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të djalit T.A, me balancë llogarie në datën 26.1.2017, shuma 5,002.79 lekë. Rezultoi se kjo është një llogari e hapur në emër të djalit të subjektit ku kanë kaluar të ardhura të përfituara nga lindja në vlerën 5,000 lekë, të cilat janë maturuar në vazhdim.

¹³ Subjekti ka sjellë deklaratë noteriale të datës 12.9.2023 të bashkëshortëve S (blerësit e pasurisë së nënës), në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

5.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë depozitë të deklaruar nga subjekti.

6. Të ardhurat

6.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura të tij dhe personave të lidhur: “*Të ardhurat nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Elbasan në periudhën 1.2.2000 – 15.3.2001, në shumën 509,152 lekë.*

Të ardhurat nga paga si prokuror në periudhën 15.3.2001 – 31.12.2016 në prokuroritë e rretheve Mirditë dhe Lezhë, ku tek shuma e të ardhurave do të përfshihen më vete raportet mjekësore të paguara për periudhat 14.2.2012 – 21.7.2012 dhe 3.7.2014 – 28.8.2014 të siguruar nga DRSSH Lezhë. Shuma: 16,160,585 lekë. Raportet për periudhën e vitit 2012 në shumën 345,114 lekë. Raportet për periudhat e vitit 2014 në shumën 126,840 lekë. Gjithsej 16,632,839 lekë.

*Të ardhurat nga pensioni i babait tim, të ndjerit T.A (vdekur më 11.1.2003) për periudhën 1.6.1993 – 30.12.2002, sipas vërtetimit nr. ***, datë 25.1.2017, të lëshuar nga DRSSH-ja Tiranë, në shumën 478,955 lekë.*

*Të ardhurat nga pensioni i nënës sime L.A, e cila pas vdekjes së babait tim T.A, ka përfituar: (1) pensionin familjar në periudhën 12.1.2003 – 30.1.2009, në shumën 354,992 lekë; (2) pension pleqërie që merr aktualisht me datë fillimi 14.2.2008 – 31.1.2017, në shumën 1,309,015 lekë, sipas shkresës nr. *** prot., datë 24.1.2017, të DRSSH-së Tiranë. Të ardhura gjithsej 1,663,607 lekë.*

*Të ardhurat e bashkëshortes sime O.A, por që bëhet fjalë për të ardhurat nga paga e saj para lidhjes së martesës, më 3.2.2006, me mbiemër vajzërie Gj, nga paga si sekretare gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë, në periudhën 7.5.1996 – 15.11.2004, të krijuara gjatë kohës që ende nuk ishte lidhur martesa me subjektin e lidhur më 3.2.2006, të shpenzuara në familjen e prindërve të mi, kjo sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 24.1.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Vlera: 1,046,651 lekë.*

*Të ardhurat nga paga e bashkëshortes sime O. A, por që bëhet fjalë për të ardhura nga paga e saj para lidhjes së martesës, më 3.2.2006, me mbiemër të vajzërisë Gj, në subjektin “***” sh.p.k., M, në periudhën 1.12.2005 – 31.12.2005, të shpenzuara në familjen e saj, të krijuara para lidhjes së martesës më 3.2.2006, në shumën 11,313 lekë.*

*Të ardhura nga pagesa e raporteve të lindjes së bashkëshortes datë 28.1.2006 – 28.1.2007, vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, të Agj. Lok. Sig. Shoq. M, në shumën 108,940 lekë”.*

6.2 Të gjitha të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting*, të cilat janë vërtetuar nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit dhe familjarëve të tij, si dhe të ardhurat nga pensioni dhe raportet nga ISSH-ja, janë përfshirë në analizën financiare sipas viteve përkatëse.

6.3 Edhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip “***”, me targë AA *** CG, sipas kontratës së shitblerjes datë 1.10.2012, me palë shitëse subjektin e rivlerësimit dhe palë blerëse H. H. në shumën 400,000 lekë janë përfshirë në analizën financiare si të ardhura të ligjshme, sipas trajtimit të bërë në pikën 1 të këtij vendimi.

7. Të ardhurat nga qiraja

7.1 Komisioni hetoi lidhur me dhënien me qira të një dhome me sip. 15.9 m², në ap. ***, p. *** shk. ***, rruga “***”, Tiranë, dhe të ardhurat e krijuara nga kjo marrëdhënie qiraje, nga ku rezultoi se babai i subjektit, i ndjeri T.A (ndërruar jetë më 11.1.2003), nëna L.A dhe motra A.A janë pronarë të pasurisë së dhënë me qira. Periudha e qirasë është 15.11.2001 – mars 2005. Vlera e qirasë në shumën mujore 10,000 lekë. Shuma totale e përfituar 390,000 lekë.

7.2 Me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga DRT-ja Tiranë, konfirmohet pagesa për tatimin në burim në lidhje me qiranë për periudhat 2001 – 2003, janar 2004 – mars 2004, prill 2004 – mars 2005, në shumën totale 40,590 lekë. DRT Tiranë¹⁴ ka konfirmuar se nga nëna L.A është paguar tatim mbi qiranë, si vijon:

- për vitin 2001 shuma 1,590 lekë, më 6.2.2002;
- për vitin 2002 shuma 12,000 lekë, më 18.3.2003;
- për vitin 2003 shuma 12,000 lekë, më 26.1.2004;
- periudha janar – mars 2004, shuma 3,000 lekë, më 13.2.2004;
- periudha prill 2004 – mars 2005, shuma 12,000 lekë, më 2.4.2005.

7.3 Komisioni e pyeti subjektin lidhur me dhënien më qira të pasurisë apartament në rrugën “***”, Tiranë, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. *** deklaroi: *“Shprehem se apartamenti ***, p. ***, shk. ***, në rrugën “***”, Tiranë, është apartament si rrjedhojë e privatizimit të banesës të datës 18.3.1993. Nga prindërit e mi, një dhomë e apartamentit ***, p. ***, shk. ***, me sip. 70.5 m², në rrugën “***”, Tiranë, dhomë kjo, në sipërfaqen 19.5 m², është dhënë me qira shtetasit J. M. Bëhet fjalë për një shumë parash prej 10,000 lekësh në muaj, që merreshin nga prindërit çdo muaj dhe janë përdorur nga ato për nevoja familjare”.*

7.4 Subjekti ka paraqitur: kopje me shkresë të thjeshtë të kontratës së qirasë të datës 15.11.2001 (njëvjeçare), ku qiraja mujore ishte 10,000 lekë; kopje të kontratës së qirasë, datë 15.11.2002; kopje të kontratës së qirasë datë 15.11.2004, për një periudhë njëvjeçare.

7.5 Të ardhurat nga qiraja të përfituara nga nëna e subjektit gjatë kësaj periudhe janë përfshirë si të ardhura të ligjshme në vitet përkatëse në analizën financiare, pasi është provuar pagimi i detyrimeve tatimore.

7.6 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se nuk u konstatuan problematika lidhur me këto të ardhura të deklaruar nga subjekti.

8. Deklarimi i bashkëshortes së subjektit, znj. O.A

8.1 Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar *“Llogari bankare të djalit T. A. A, hapur një llogari depozite nga Bashkia e Tiranës”*, llogari e trajtuar më sipër. Gjithashtu, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar edhe të ardhurat e përfituara ndër vite nga marrëdhëniet e punës.

9. Deklarimi i nënës së subjektit, znj. L.A

9.1 Nëna e subjektit, znj. L.A, ka deklaruar pasuritë e paluajtshme të trajtuara në pikat 3 dhe 4 më sipër, të ardhurat nga pensioni i saj dhe bashkëshortit, si dhe të ardhurat nga qiraja.

10. Analiza financiare

10.1 Analiza financiare është e ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin periudhën 1993 – 2002, e cila është bërë në bllok për subjektin dhe familjarët e tij, për shkak se ai ka deklaruar për herë

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2018.

të parë në vitin 2003 pranë ILDKPKI-së. Të ardhurat e para të dokumentuara për subjektin janë në vitin 2000 nga puna e tij si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

10.2 Pjesa tjetër e analizës është bërë për periudhën 2003 – 2016, në të cilën subjekti është deklarues pranë ILDKPKI-së, prandaj edhe analiza financiare është bërë vit pas viti për këtë hark kohor.

10.3 Në vitin 2013, gjendja *cash* është vlerësuar në vlerën 1,557,000 lekë (957,000 + 870,000 - 270,000). Kjo vlerë bazohet në vlerën e vitit paraardhës (957,000 lekë), së cilës i janë shtuar kursimet e deklaruara të vitit 2013 (870,000 lekë) dhe i janë zbritur shpenzimet për blerjen e automjetit të blerë me kursime në vitin 2013 (270,000 lekë)¹⁵.

¹⁵ Shihni pikën 2 të këtij vendimi.

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ARBEN T. AGOVI																
PERSHKRIMI	1993 - 2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	2,033,004	0	0	22,033	-21,976	602	324,850	379,811	352,587	104,316	601,890	888,209	278,255	-692,197	135,025	3,101,004
Apartament 70.5 m2 Rr. ****, Tirane - L. A. - 1/3	13,616															13,616
Truall + objekt 69.7 m2 - privatizuar ne 1993 -L. A.	119,388															119,388
Apartament Rr. ****, Tirane - 47.3 m2 - T. A. - 2001	1,900,000															1,900,000
Automjet Mercedes Benz - **** - Arben Agovi - 2011 - 5,700€										798,000						798,000
Automjet Daimler Chrysler*** - 2013 - Arben Agovi - 100%												270,000				270,000
Ndryshim ne likuiditet		0	0	22,033	-21,976	602	324,850	379,811	352,587	-693,684	601,890	618,209	278,255	-692,197	135,025	
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	2,033,004	0	0	22,033	-21,976	602	324,850	379,811	352,587	104,316	601,890	888,209	278,255	-692,197	135,025	3,101,004
TE ARDHURA dokumentuar	4,356,911	734,996	1,539,232	1,355,285	1,309,003	1,192,394	1,254,134	1,349,057	1,408,600	1,267,867	1,481,351	1,215,705	1,325,295	1,434,579	1,514,102	22,738,511
Te ardhura nga subjekti	1,472,381	579,307	1,228,808	1,259,758	1,137,291	1,124,251	1,065,480	1,198,115	1,256,464	1,109,195	917,346	1,046,987	1,152,191	1,258,654	1,335,463	17,141,691
Te ardhura nga b/shortja e subjektit			149,232	11,313	108,940	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	269,485
Te ardhura nga pensioni i babai te subjektit	478,953															478,953
Te ardhura nga qira objekti, paga dhe pensioni i nenes se subjektit	505,577	155,689	161,192	84,214	62,772	68,143	188,654	150,942	152,136	158,672	164,005	168,718	173,104	175,925	178,639	2,548,382
Te ardhura nga shitja e truall + apartament 69.7 m2 nena e subjektit - 2002	1,900,000															1,900,000
Te ardhura nga shitja e automjetit Benz **** - 2012											400,000					400,000
SHPENZIME	1,740,693	376,231	471,892	438,671	529,969	661,480	651,940	639,373	842,386	956,610	751,012	842,656	1,297,090	1,315,349	1,344,107	11,118,765
Shpenzime jetese	1,427,693	266,231	281,892	328,671	419,969	546,480	546,480	546,480	683,100	683,100	697,740	705,120	1,099,990	1,121,380	1,175,460	10,529,785
Shpenzime mobilimi dhe elektroshtepiake			80,000						50,000				65,000	80,000	53,000	328,000
Shpenzim per dergese vellait te b/shortes - 2011										138,300						138,300
Shpenzime per transport nderqytetas	313,000	110,000	110,000	110,000	110,000	115,000	105,460	92,893	109,286	127,603	52,574	136,134	131,400	113,969	114,970	1,852,288
Shpenzime udhetimi		0	0	0	0	0	0	0	0	7,607	699	1,402	701	0	676	11,084
Analiza dokumentuar	583,215	358,765	1,067,340	894,581	801,010	530,312	277,344	329,873	213,628	206,941	128,449	-515,160	-250,050	811,427	34,970	4,889,430
																Pamundesia financiare totale
																-765,210
Gjendje CASH (sipas deklarave periodike)							305,000	705,000	955,000	357,000	957,000	1,557,000	1,857,000	1,100,000	1,300,000	
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT		0	0	22,033	57	659	325,509	705,320	1,057,907	364,223	966,113	1,584,322	1,862,577	1,170,380	1,305,405	

10.4 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe familjarët e tij kishin një pamundësi financiare totale prej -765,210 lekësh për shtimin e pasurive dhe likuiditeteve, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës 1993 – 2016.

10.5 Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit lidhur me analizën financiare, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.6 Në lidhje me pamundësinë financiare, subjekti deklaroi se i qëndron shpjegimit për sa i takon konstatimeve në lidhje me pamundësinë financiare në shumën -515,160 lekë.

10.7 Sipas subjektit, për shkak të interpretimit që ai sjell për gjendjen e kursimeve *cash* gjatë viteve, rezultatet e viteve 2011 – 2014 duhej të ishin si në vijim:

- Në qoftë se do të konsiderohej pakësimi i gjendjes *cash* në vitin 2011 për shpenzimin prej 1,000 euro, dërguar vëllait të bashkëshortes, rezultati financiar i këtij viti do të ishte 346,941 lekë.

- Në qoftë se do të konsiderohej gjendja *cash* në vitin 2011 sipas pretendimit të subjektit, rezultati financiar i vitit 2012 do të ishte 177,949 lekë.

- Në qoftë se do të konsiderohej gjendja *cash* në vitin 2013 sipas pretendimit të subjektit, rezultati financiar i këtij viti do të ishte 301,840 lekë.

- Për vitin 2014, subjekti pretendon se ka pasur shpenzime familjare më të ulëta sesa indeksimi për vitin 2014.

Vlerësimi i Komisionit

10.8 Referuar deklaratimeve që subjekti ka bërë në deklaratimet periodike vjetore, pretendimet e subjektit lidhur me interpretimin e gjendjes së kursimeve *cash* (trajtuar më sipër në pikën 2 të këtij vendimi) nuk u morën parasysh nga Komisioni. Si rrjedhim, Komisioni vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara dhe se nuk do të reflektohen në analizën financiare.

10.9 Lidhur me shpenzimet e jetesës në vitin 2014, Komisioni ka përdorur një standard të këtyre shpenzimeve sipas ILDKPKI-së dhe ky parametër nuk mund të ndryshohet.

10.10 Në përfundim, analiza financiare e dërguar në rezultatet e hetimit, edhe pas marrjes në shqyrtim të pretendimeve të subjektit, mbetet e pandryshuar duke rezultuar me një pamundësi financiare totale në një vlerë prej -765,210 lekësh për shtimin e pasurive dhe likuiditeteve, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës 1993 – 2016.

10.11 Gjithsesi, Komisioni këtë pamundësi financiare të shtrirë në vite bazuar në parimin e proporcionalitetit nuk e konsideron problematike për të penalizuar subjektin e rivlerësimit. Referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kjo mungesë burimesh financiare nuk mund të konsiderohet si deklaratim i pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

11. Metodologjia

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

11.1 Për hartimin e kësaj analize Komisioni është bazuar në:

- a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe bashkëshortes, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga Raiffeisen Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.
- b. Ndryshimi i gjendjes *cash* është bërë nga Komisioni bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti ndër vite në DPV-të e dorëzuara në ILDKPKI¹⁶.

c. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat nga pagat e subjektit si: OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Elbasan (2000 – 2001); prokuror në Prokurorinë e Rrethit Mirditë dhe Lezhë (2001 – 2016); nga përfitime afatshkurta – prokuror në Prokurorinë e Rrethit Lezhë (2012 dhe 2014).

ii) Të ardhurat nga paga e bashkëshortes së subjektit si: sekretare gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë nga viti i martesës (2004); te shoqëria “****” sh.p.k. (2005); nga raporte leje lindje 28.1.2006 – 28.1.2007.

iii) Të ardhurat nga pensioni i babait të subjektit sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 20.9.2023, të DRSH-së Tiranë (1993 – 2002).

iv) Të ardhurat nga paga e nënës së subjektit tek shoqëria “****” sh.p.k. (1995 – 2000) sipas vërtetimit të bazës së vlerësueshme për ISSH-në.

v) Të ardhurat nga pensioni familjar dhe i pleqërisë i nënës së subjektit sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 20.9.2023, të DRSH-së Tiranë (2003 – 2016).

vi) Të ardhurat nga qiraja e një dhome tek apartamenti në bashkëpronësi të nënës së subjektit 1/3, për të cilat janë vërtetuar pagesat e detyrimeve tatimore nga DRT Tiranë (2001 – 2005).

vii) Të ardhurat nga shitja e truall + apartament me sip. 69.7 m² nga prindërit e subjektit (2002), sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 11.1.2002.

viii) Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****”, me targë AA *** CG (2012), sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 1.10.2012.

ç. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i).

ii) Shpenzime mobilimi dhe elektroshtëpiake, sipas deklaratimit të subjektit në përgjigje pyetësori (2004, 2010, 2014 – 2016).

iii) Shpenzim për dërgesë vëllait të bashkëshortes sipas deklaratimit të subjektit në përgjigje pyetësori dhe transaksionit bankar (2011).

¹⁶ Shihni pikën 2 në këtë vendim.

iv) Shpenzime për transport ndërqytetës sipas deklaramit të subjektit në përgjigje pyetësori (2000 – 2016).

v) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur janë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

d. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁷.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit

12. Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në provat që disponon, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

13. Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklaramive të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, AKSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4, dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar (klasifikuar “Sekret”) me nr. *** prot., datë 2.11.2017, ku rezulton se:

- Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaramitën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.
- Konstatohet se subjekti i rivlerësimit Arben Agovi është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

13.1 Për pastërtinë e figurës nuk ka pasur të dhëna e dyshime bazuar në raportin e AKSIK-së.

13.2 Me shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2023, AKSIK-së iu kërkua përditësimi dhe deklasifikimi i raportit të figurës për subjektin e rivlerësimit.

¹⁷ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

13.3 Më 25.9.2023 është paraqitur raporti i deklasifikuar plotësisht i AKSIK-së (nr. *** vendimi, datë 20.9.2023), ku konstatohet se për subjektin Arben Agovi nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar. Sa më sipër, *konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.*

Bazuar në faktet e sipërpërmendura

14. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

14.1 Subjektit i rivlerësimit e ka dorëzuar në kohë deklaratën e kontrollit të figurës sipas ligjit.

14.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të pasaktë dhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

15. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve e kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

16. Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Arben Agovi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

17. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

18. Për periudhën e rivlerësimit z. Arben Agovi ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

19. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

19.1 Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit; 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti; 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënave nga burimet arkivore.

20. Subjekti i rivlerësimit Arben Agovi, në datën 26.1.2017 ka dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme formularin e vetëvlerësimit profesional dhe dokumente shoqëruese.

21. Sipas të dhënave konstatohet se me Dekretin nr. ***, datë 16.3.2001, të Presidentit të Republikës subjekti Arben Agovi është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë. Me Dekretin nr. ***, datë 4.9.2007, të Presidentit të Republikës është transferuar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

22. Me vendimin nr. ***, datë 24.1.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

23. Nga të dhënat statistikore, për periudhën e rivlerësimit, prokurori Arben Agovi ka trajtuar gjithsej 662 çështje penale bashkë me pezullimet, nga të cilat u përzgjedhën për shortim 517 çështje.

24. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti ligjor 1 – Konkluzione përfundimtare në lidhje me çështjen penale nr. ***, viti 2013. Në rastin konkret kjo çështje është proceduar me formën e gjykimit të shkurtuar.

Dokumenti ligjor 2 – Konkluzione përfundimtare në lidhje me çështjen penale nr. ***, viti 2016. Subjekti i rivlerësimit për këtë çështje ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe dënimin sipas llojeve dhe masave të dënimit të parashikuara në dispozitën konkrete të Kodit Penal.

Dokumenti ligjor 3 – Kërkesa për gjykim në kuadër të çështjes penale nr. ***, viti 2015.

Kërkesa për gjykim përmban nënshkrimin e prokurorit Arben Agovi dhe është hartuar konform parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këto 3 dokumente ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

25. Pesë dosjet penale dhe dokumentet ligjore të përzgjedhura me short

Dosja 1 – Kallëzimi penal nr. ***, datë regjistrimi 5.5.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Dokumenti ligjor – vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 11.5.2015, përpiluar nga prokurori Arben Agovi.

Dosja 2 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 17.10.2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 16.12.2013, përpiluar nga prokurori Arben Agovi.

Dosja 3 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 14.5.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Vendim “Për pushimin e procedimit penal” datë 20.5.2014, hartuar nga prokurori Arben Agovi, subjekt rivlerësimi.

Dosja 4 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 13.10.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal” datë 13.7.2015, hartuar nga prokurori Arben Agovi, subjekt rivlerësimi.

Dosja 5 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 21.11.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal”, datë 25.11.2015, përpiluar nga prokurori Arben Agovi, subjekt rivlerësimi.

TË DHËNAT NGA BURIMET ARKIVORE

26. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit Arben Agovi rezulton se ndaj tij nuk është marrë ndonjë masë disiplinore.

27. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2020, ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit Arben Agovi është regjistruar një kallëzim penal për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 17.1.2019.

28. Për subjektin e rivlerësimit përgjatë periudhës 2006 – 2020 janë regjistruar 8 ankesa.

ANALIZA E GJETJEVE

29. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Arben Agovi, tregon korrektësi në zbatimin e ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

30. Aktet e subjektit janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe urdhrit nr. ***, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”.

31. Rezulton se në aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit i kushtohet rëndësi pasqyrimin të përmbajtjes së provave, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme përmbajtjen e tyre, si dhe tregimit të rrethanave të faktit. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori.

32. Rezulton se konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal mbështetet në analizimin dhe argumentimin e elementeve të figurës së veprës penale. Në të gjitha aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe në dosjet e shortuara janë analizuar në mënyrë të hollësishme ose të përmbledhur elementet e veprës penale objekt hetimi.

33. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal dhe të Kushtetutës, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet.

34. Për vitet 2014 – 2016, subjekti i rivlerësimit Arben Agovi ka pasur vlerësimin e punës në nivel “Shumë mirë”.

DENONCIMET E PUBLIKUT

35. Për subjektin e rivlerësimit Arben Agovi janë paraqitur gjithsej 15 denoncime.

35.1 Denoncime nr. * prot., datë 17.10.2017, nr. *** prot., datë 23.11.2017 dhe nr. *** prot., datë 2.2.2018, të shtetasit D.P.** Denoncuesi shprehet se ka bërë kallëzim penal për falsifikim dhe tjetërsim prone dhe është mbyllur pa hetim nga subjekti i rivlerësimit.

Për këtë çështje Komisioni i dërgoi shkresë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2023, kjo Prokurori ka vënë në dispozicion praktikën mbi vendimin penal datë 24.7.2017. Rezultoi se në datën 24.7.2017 subjekti Arben Agovi ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 12.7.2017. Në vendim arsyetohet se Prokuroria e Rrethit Lezhë ka regjistruar më parë kallëzimin penal nr. ***, datë 10.10.2016 (ndjekur nga prokurori S. K). Në datën 9.11.2016 është vendosur moskallëzimi penal pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Ky vendim rezulton që t'i jetë dërguar në adresë të denoncuesit me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2016. Nuk është konstatuar që ndaj këtij vendimi të jetë bërë ankim në Gjykatë. Prokuroria e Rrethit Lezhë ka kryer verifikimet përkatëse lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë 10.10.2016, ku rezultoi të jetë i njëjtë me kallëzimin penal nr. ***, datë 12.7.2017. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit është shprehur në vendim se gjendet para të njëjtave fakteve për të cilat denoncuesi ka bërë kallëzim penal më parë (ndodhet para gjësë së gjykuar) dhe është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal nr. ***, datë 12.7.2017”.

Kundër vendimit të subjektit të rivlerësimit është bërë ankim në Gjykatë. Në datën 16.10.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. ***, ka vendosur “Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, viti 2017”. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër (vendimi nr. ***, datë 18.12.2017).

Për sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me ndjekjen e kësaj çështjeje penale nga subjekti i rivlerësimit.

35.2 Denoncim nr. * prot., datë 30.5.2018, i shtetases L.B.** Kjo shtetase denoncon subjektet A dhe P pasi, sipas saj, historia e shkeljeve fillon në vitin 2005 nga këto subjekte. Denoncuesja ka bërë kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit, por çështja është mbyllur nga prokurori i rrethit Pukë. Gjithashtu, denoncuesja pretendon se këto 2 subjekte mbyllin çështje që nuk duhen mbyllur dhe hapin çështje që nuk duhen hapur. Nisur nga historia e shkeljes së pretenduar në vitin 2005 dhe mosdenoncimit konkret për ndonjë çështje të ndjekur nga subjekti, Komisioni nuk konstatoi informacion të nevojshëm për fillim hetimi sipas pikës 2 të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, sipas pikës 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim.

35.3 Denoncim nr. * prot., datë 17.9.2018, i shtetasit Z.Gj.** Materiali i paraqitur nga ky denoncues është në formën “Kallëzim penal” ndaj 15 personave. Në këtë kallëzim flitet për një çështje të ndjekur në vitin 2001. Bazuar në pikën 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk hetoi më tej, pasi vlerësimi i aftësive profesionale për subjektet mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim.

35.4 Denoncim nr. * prot., datë 13.3.2019, i shtetases Xh.J.** Kjo shtetase denoncon disa subjekte, gjyqtarë dhe prokurorë, për shpërdorim detyre, pasi mbrojnë krimin dhe autorët e kryerjes së veprave penale. Bashkëlidhur ka paraqitur disa materiale, vendime të Prokurorisë, vendime gjyqësore dhe korrespondenca të ndryshme. Në këtë denoncim nuk paraqitet ndonjë rrethanë konkrete apo shkelje e mundshme e pretenduar ndaj subjektit të rivlerësimit.

35.5 Denoncim nr. * prot., datë 24.7.2019, i shtetasit N.K.** Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore që janë urdhëruar nga Gjykata e Apelit Shkodër. Për këtë çështje iu dërgua shkresë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2023, kjo Prokurori ka vënë në dispozicion praktikën mbi vendimin penal nr. ***, viti 2016. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka rifilluar hetimet mbi këtë procedim më 13.4.2018 (pasi kjo çështje është ndjekur nga një tjetër prokuror). Pas hetimeve në datën 3.4.2019 ka dërguar në Gjykatë kërkesën për pushimin e hetimeve. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 5.6.2019, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Kërkesa e subjektit për pushimin e çështjes penale nr. ***, datë 13.1.2016, duket se është bërë pas analizimit të fakteve dhe provave të administruara në dosjen hetimore, si dhe kryerja e disa veprimeve të tjera hetimore dhe procedurale. Në përfundim është konkluduar se veprat penale për personat e akuzuar janë parashkruar (neni 3 i Kodit Penal – kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale).

Lidhur me këtë çështje, Komisioni konstatoi se:

- Subjekti duket se nuk ka respektuar udhëzimet e gjykatave, që e kanë urdhëruar atë të hetojë në mënyrë të detajuar me një orientim të veçantë për përdorimin e dokumenteve të falsifikuara pas qershorit 2006.
- Vendimi i Gjykatës së Apelit është dhënë në nëntor 2017. Prokuroria e ka hedhur në short çështjen në prill të vitit 2018. Subjekti duhet të shpjegojë se pse zgjati kaq shumë për regjistrimin e çështjes pas 5 muajsh nga vendimi i gjykatës. Subjekti duhet të shpjegojë se kush i ka organizuar procedurat e shortit në caktimin e kësaj lënde.
- Subjekti duket se nuk ka hetuar lidhjen e të dyshuarit kryesor me të afërmit e tij, të cilëve u është shitur pasuria e regjistruar me dokument të falsifikuar, në vitin 2006.
- Duket se subjekti nuk ka hetuar dhe sqaruar çmimin joreal të shitjes prej 500,000 lekësh të një pasurie me vlerë vetëm pak muaj më vonë në shumën 22,000,000 lekë dhe 1 vit më vonë një tepriçë prej 3,600,000 lekësh.
- Duket se subjekti nuk ka hetuar nëse i dyshuari kryesor ka pasur përfitime nga veprimtaria e të afërmeve, ndërkohë që dokumenti i falsifikuar i pronësisë është dorëzuar në banka apo aktivitete të tjera biznesi ndër vite.
- Duket se subjekti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të verifikuar veprimtarinë e OPGJ-së, e cila supozohej (bazuar në urdhrin e të vlerësuarit të prillit 2018) të paraqiste rezultatet e hetimit brenda qershorit 2018. Vetëm në tetor 2018 (pothuajse 6 muaj pas) vlerësuesi gjeti se OPGJ-

ja nuk po ndiqte udhëzimet e tij dhe ato të gjykatave, pasi OPGJ-ja ishte e bindur se çështja duhej të pushohej përsëri në afatet kohore. Për më tepër, urdhri i caktuar për OPGJ-në, për të hetuar, ishte shumë i përgjithshëm dhe pa përcaktuar asnjë hap hetimor për të plotësuar kërkesat e gjykatave.

- Gati në 1 vit hetimi, subjekti i vlerësimit duket se nuk ka regjistruar asnjë emër të personit të cilit i atribuohet vepra penale, nuk ka dhënë shtyrje dhe ka motivuar vendime, çdo 3 muaj, siç kërkohet nga Kodi i Procedurës Penale.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit parashtroi: *“Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, me prokuror M. B., rezultoi të jetë regjistruar fillimisht procedimi penal nr. ***, datë 13.1.2016, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, pa emër personi që t’i atribuohet vepra penale, ku rezultoi të jetë vendosur me datë 19.4.2016, pushimi i procedimit penal sipas nenit 328, pika 1, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Penale.*

Vetëm pas kryerjes së disa veprimeve hetimore Prokuroria mund të arrinte në një konkluzion të saktë në lidhje me vazhdimin e hetimeve dhe dërgimin e tyre në gjyq apo pushimin e hetimeve. Për këtë është konkluduar me kërkesën e datës 3.4.2019 me objekt “Pushimi i çështjes penale”, duke parashtruar rezultatin e veprimeve hetimore të kryera sikurse ka orientuar Gjykata.

Në lidhje me detyrën e lënë nga Gjykata dhe konkretisht hetimin e veprimeve të konsideruara si të paligjshme nga ana e kallëzuesit dhe në përfundim të arrihet në konkluzionin nëse jemi para elementeve të veprave penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, rezultoi se organi i akuzës ka kryer hetime të mirëfillta në lidhje me këtë detyrë të Gjykatës, duke arritur në konkluzionin se të gjithë shtetasit e kallëzuar nga shtetasi N.K kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin dhe kanë konsumuar vepra penale, duke përcaktuar edhe datat dhe kohën se kur janë kryer veprimet e kundërligjshme nga ana e të kallëzuarve ...duke i cituar ato.

Gjykata vlerëson në vendimin e saj se organi i akuzës, ashtu siç citohet edhe më sipër, ka verifikuar të gjitha veprimet konkrete dhe kohën e kryerjes së tyre dhe, duke pasur parasysh kohën e kryerjes së tyre, ka arritur në konkluzionin se ndjekja penale është parashkruar, duke qenë se veprimi i fundit është i datës 19.10.2006.

Procedurat e shortit sikurse dhe rezultoi janë organizuar nga ana e Zyrës së Regjistrimit nën monitorimin e Drejtuesit të Prokurorisë dhe kjo konstatohet pikërisht nga procesverbali i Hedhjes së Shortit Manual datë 12.4.2018.

Sa i takon lidhur me hetimin e lidhjeve të dyshuarit kryesor me të afërmit e tij, të cilëve u është shitur pasuria, gjatë fazës së hetimeve, e theksoj pas rifillimit të hetimeve, është proceduar jo vetëm me administrimin duke cituar këtu sekuestrimin e praktikës në fjalë, pranë ish-ZVRPP-së Lezhë, ku ndodhet e gjithë praktika konkrete dhe ku janë cituar edhe aktet konkrete, por është proceduar edhe me marrjen e deklarimeve në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit shtetasit N. T, sipas procesverbalit përkatës datë 12.12.2018, ku shtetasi në fjalë shprehet se shtetasit P.V dhe N.V janë djemtë e dajës së tij.

*Sa i takon lidhur me mosverifikimin e çmimit të shitjes së pasurisë fillimisht në një vlerë prej 500,000 lekësh dhe disa muaj më vonë në shumën 22,000,000 lekë dhe 1 vit më vonë një tepriçë prej 3,600,000 lekësh, duhet të përmend faktin e rezultuar nga administrimi i praktikës pranë ish-ZVRPP-së Lezhë, se mes familjarëve T, N. T etj. dhe P. V e N.V të jetë lidhur akti noterial kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.10.2016, ku palët të kenë rënë dakord për çmimin e shitjes në vlerën 500,000 lekë. Pra, është një marrëveshje mes palëve dhe ku nga hetimet e kryera të paktën deklaratimet e shtetasit N.T, nuk deklarohet apo kallëzohet që veprimi të jetë kryer jo në kushte marrëveshjeje reciproke, ndërkohë që këtu vlen të përmendet, nisur edhe nga parashtrimi juaj dhe arsyetimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 5.6.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbi pretendimin e kallëzuesit për krime vazhduese, ku nga Gjykata u vlerësua se ky pretendim nuk qëndronte, nisur nga qëndrimi që është mbajtur nga Gjykata e Apelit Shkodër.*

Sa i takon lidhur me përfitimet që mund të ketë pasur i dyshuari kryesor dhe këtu kuptohet shtetasi N.T, nga veprimtaria e të afërmeve, nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar që shtetasi N.T të ketë pasur përfitime të tjera, ves sa çmimit të shitjes së sipërfaqes së tokës në fjalë, ndërkohë që sikurse konstatohet nga informacioni dhe dokumentacioni i ish-ZVRPP-së Lezhë, pasuria ka urdhra për kufizim e sekuestrim, por që nuk rezulton të jetë shtetasi N.T apo familja e tij (certifikata familjare), ndërkohë që nuk ka rezultuar që personat që kanë blerë sipërfaqen e tokës nga shtetasi N.T të kenë marrë pjesë në veprimtarinë e kundërligjshme që lidhet me falsifikimin e dokumentacionit apo edhe të momenteve që lidhen me shpërdorimin e detyrës nga funksionarët përkatës.

*Sa i takon lidhur me mosregjistrimin e emrave të personave që u atribuohet vepra penale, nuk janë dhënë shtyrje, zgjatje afatesh dhe motivuar vendime çdo tre muaj, bëj me dije sikurse dhe ka rezultuar se nisur nga detyrat konkrete dhe rezultantja e tyre është arritur në konkluzionin se personat konkretë të kenë kryer veprime të kundërligjshme, në kuptim të realizimit të figurave të veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”. Por, nisur nga koha e kryerjes së këtyre veprimeve nuk mund të procedohej me regjistrimin e emrave të këtyre shtetasve si persona që u atribuoheshin veprat penale konkrete, pikërisht nisur nga “Instituti i Parashkrimit” dhe ky qëndrim është pasqyruar në kërkesën me objekt “Pushimi i çështjes penale”, ku dhe Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, me vendimin e saj nr. ***, datë 5.6.2019, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë”.*

Vlerësimi i Komisionit

Për këtë rast subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse. Nuk konstatohen problematika thelbësore për subjektin e rivlerësimit në këtë çështje nga momenti i fillimit të hetimit nga ana e tij.

Për këtë çështje dhe për raste të tjera është evidentuar se vërtet Gjykata ka kthyer për hetime të mëtejshme çështjen, por në fund ka vendosur pushimin e çështjes sipas kërkesës së Prokurorisë. Gjykata ka konstatuar se vepra penale është parashkruar dhe nga ana tjetër është investuar dhe ka kërkuar që të kryhen veprime të tjera hetimore nga Prokuroria.

35.6 Denoncim nr. * prot., datë 24.9.2019, i shtetasit E.K.** Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit të marrë në datën 6.6.2019 dhe pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit P. P. Denoncuesi thotë se është pronar i 8,800 m² tokë, ndodhur në fshatin I, Lezhë, Njësia Administrative Shëngjin, Lezhë, pronë e trashëguar dhe e marrë me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, me AMTP-në nr. ***, datë 1993. Një pjesë e kësaj prone në mënyrë abuzive i është pushtuar nga një banor kufitar P. P, i cili ka qenë banor i fshatit I, Lezhë, para gushtit 1991 (me 4 frymë) dhe rezultoi i pajisur me tokë (gjithsej 17,090 m²). Sipas denoncuesit ai ka falsifikuar dokumentin AMTP, ku në vend të 15,000 m² ai, nëpërmjet dokumentit të falsifikuar, rezultoi me 17,000 m² tokë të përfituar sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”. Denoncuesi ka paraqitur kallëzim penal në prokurori për pushtim të paligjshëm të tokës, përvetësim të paligjshëm të pasurisë publike dhe falsifikimit të dokumenteve zyrtare nga shtetasi P. P. Denoncuesi pretendon se ka mbi 16 vjet që nuk gjen drejtësi dhe arsyeja se përse i drejtohet përfaqësuesve të Reformës në Drejtësi është absurditeti i vendimit të datës 6.6.2019 të prokurorit, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, z. Arben Agovi, i cili i ka kërkuar Gjykatës pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 185/1 dhe 248 të Kodit Penal. Denoncuesi citon dy vendime gjyqësore¹⁸ me të cilat i është dhënë pjesërisht e drejta në lidhje me pushtimin e 2,200 m² tokë nga shtetasi kufitar P. P. (vendimi i pazbatuar dhe i ankimuar nga pushtuesi i tokës) dhe në lidhje me pushtimin e 3,325.9 m² tokë (vendim i ankimuar).

Për këtë denoncim është kërkuar praktika në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2023, kjo Prokurori ka vënë në dispozicion praktikën mbi procedimin penal nr. ***, viti 2018, nga ku rezultoi se në datën 6.9.2019 subjekti i rivlerësimit ka dërguar në Gjykatë “Kërkesën për pushimin e hetimeve” për veprat penale të parashikuara nga nenet 186/1 dhe 248 të Kodit Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale sipas nenit 66/1/c të Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. ***, datë 22.7.2020, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë e kthimin e akteve për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për pushimin e pjesës së hetimeve në lidhje me veprën penale, të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal ...etj.”. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim prokurori pranë Gjykatës së Apelit. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 6.11.2020, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 22.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me arsyetimin se shkaqet e ngritura në ankim nga shtetasi, denoncuesi E.K, çojnë në konkluzionin se vendimi i Shkallës së Parë (nr. ***, datë 22.7.2020) është i bazuar plotësisht në ligj dhe në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

Subjekti, në datën 23.6.2021 ka ridërguar në Gjykatë kërkesën për pushim hetimi, e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 15.2.2022, duke vendosur pushimin e hetimeve për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186/1/2 e 248 dhe deklarimin e falsitetit të dokumentit AMTP me nr. ***, pa datë, lëshuar në emër të shtetasit P. P.

¹⁸ Shihni bashkëlidhur denoncimet nr. ***, datë 6.1.2014 dhe nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 17.6.2022, duke e kthyer për rigjykim përsëri pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Më pas, kjo e fundit, me vendimin nr. ***, datë 1.11.2022, ka vendosur “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë duke pushuar hetimet për procedimin penal nr. ***, viti 2018, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186/1/2 dhe 248 të Kodit Penal”.

Në kërkesën e subjektit drejtuar Gjykatës për pushimin e hetimeve janë renditur hetimet e kryera, praktikat e administruara, si dhe është bërë vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, të cilat kanë shërbyer për të kërkuar pranë Gjykatës pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin e datës 22.7.2020, ka vlerësuar të gabuar përfundimin e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje duke mos u hetuar plotësisht fakti penal. Organi i akuzës nuk e ka shtrirë hetimin nëse kemi të bëjmë apo jo me veprime të kryera në kundërshtim me ligjin nga personat përgjegjës. Sipas Gjykatës, kërkesa e Prokurorisë është e papabuar në ligj dhe prova dhe e detyron këtë të fundit për vazhdimin e hetimeve.

Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota dhe shteruese, duke mos evidentuar përgjegjësitë përkatëse të personave nën hetim dhe në interpretim të gabuar të nenit 186/1 të Kodit Penal, si dhe në kundërshtim me rrethanat e çështjes në shqyrtim.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit parashtroi¹⁹: *“Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë të jetë regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2018, për veprat penale “Pushtimi i tokës” dhe “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuara nga nenet 200 dhe 248 të Kodit Penal, fillimisht, pa emër personi që t’i atribuohet vepra penale, ndërkohë që në datën 28.6.2019 është proceduar me regjistrimin e emrit të shtetasit P.P, për veprën penale “Pushtimi i tokës”, të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, ndërkohë që po me datën 28.6.2019 është proceduar me vendimin për pasqyrimin, hedhjen e të dhënave mbi një fakt të ri, në bazë të nenit 287/2 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me veprën penale “Falsifikimi i dokumentit”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.*

*Në datën 3.9.2019 është vendosur pushimi i hetimeve ndaj shtetasit P.P për veprën penale të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, pasi pati rezultuar se gjatë fazës së hetimeve u administrua shkresa nr. *** prot., datë 29.3.2019, të ALUIZNI-t Lezhë. Në datën 6.9.2019 u përpilua kërkesa për pushimin e çështjes penale të procedimit penal nr. ***, viti 2018, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, në mbështetje të rrethanave të parashikuara në nenin 328, pika 1, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Penale (ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë).*

*Në lidhje me kërkesën për pushimin e çështjes penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, nga hetimet e kryera pati rezultuar se ... ndodhemi para veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” sipas nenit 248 të Kodit Penal nga personi në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës së Fshatit që ka lëshuar AMTP-në nr. ***, pa datë ndërkohë që ndodheshim edhe para elementeve të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar*

¹⁹ Shihni shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

nga neni 186 i Kodit Penal, ku për këtë të fundit duhet bërë me dije se nga përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Lezhë, si dhe nga këqyrja e të gjitha praktikave të regjistrimit të pasurive në emrin e P.P nuk provohej se nga kush është depozituar në ZVRPP Lezhë, AMTP nr. ***, pa datë, në emrin e këtij shtetasi, ndërkohë që përfitues të rezultojë të jetë pikërisht shtetasi P.P. Regjistrimi më i hershëm është bërë në vitin 2004.

Nga këqyrja dhe marrja e një kopjeje të listës me aktet e marrjes së tokës në pronësi dhe në përdorim të fshatrave I, Lezhë dhe I, Sh rezulton se te lista e fshatit I, Lezhë, dorëzuar në ZRPP Lezhë nga Zyra e Kadastrës me datën 13.1.1998 figuron e regjistruar dhe AMTP me nr. akti *** në emrin P.P, ndërsa tek lista e fshatit I, Sh, pa datë, nuk figuron i regjistruar emri i këtij shtetasi. Ndaj përfundimisht, konkludohej se duhej proceduar me pushimin e hetimeve për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale për këto dy vepra penale për arsyet e lartpërmendura, duke i lidhur me kohën e kryerjes së veprave penale.

Rezulton se me shkresat, ndër të tjera, nr. *** prot. dhe *** prot., datë 12.9.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ndër të tjerë të jetë njoftuar shtetasi E.K lidhur me kërkesën për pushimin e çështjes penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, si dhe në lidhje me vendimin mbi pushimin e pjesshëm të hetimeve lidhur me veprën penale sipas nenit 200 të Kodit Penal ndaj shtetasit P.P. Ndaj duket që pas administrimit të vendimit dhe kërkesës si më lart të dërguara nga ana e Prokurorisë, shtetasi E.K ka depozituar denoncimin e datës 24.9.2019. Rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë ka shqyrtuar edhe kërkesën me objekt pushimin e çështjes penale të procedimit penal nr. ***, viti 2018, për veprat penale sipas neneve 186 dhe 248 të Kodit Penal, si dhe ankimin ndaj vendimit të pushimit të hetimeve ndaj shtetasit P.P për veprën penale të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, kjo e fundit në bazë të ankimit të shtetasit E.K, sikurse rezulton në pjesën hyrëse të vendimit nr. ***, datë 22.7.2020, duke konkluduar me vendimin e saj konkret.

Gjykata me këtë vendim ka vendosur: “Rrëzimin e ankimit të shtetasit E.K, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorit mbi pushimin e pjesshëm të hetimeve ndaj shtetasit P.P në lidhje me veprën penale sipas nenit 200 të Kodit Penal dhe rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë, duke kthyer aktet e procedimit penal nr. ***, viti 2018, ku Gjykata shprehet në lidhje me nenin 248 të Kodit Penal”.

Vlerësimi i Komisionit

Për këtë çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendim, ka vendosur rrëzimin e ankimit të shtetasit E.K, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorit mbi pushimin e pjesshëm të hetimeve ndaj shtetasit P.P në lidhje me veprën penale sipas nenit 200 të Kodit Penal dhe rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë, duke kthyer aktet e procedimit penal nr. ***, viti 2018, ku Gjykata shprehet në lidhje me nenin 248 të Kodit Penal.

Subjekti ka shpjeguar se për sa i takon hetimit për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, rezultoi të ishte kryer nga personi në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës së Fshatit që ka lëshuar AMTP-në nr. ***, pa datë, por që sërish ndodheshim para kriterëve që lidheshin me pushimin e çështjes penale për këtë vepër si pasojë e institutit të parashkrimit.

Në përfundim është vendosur me vendimin e Gjykatës datë 1.11.2022, pranimi i kërkesës, pushimi i hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2018, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal.

Nuk janë konstatuar problematika për subjektin e rivlerësimit për këtë çështje penale të ndjekur nga ana e tij.

35.7 Denoncime nr. * prot., datë 21.10.2019, nr. *** prot., datë 6.11.2019, nr. *** prot., datë 1.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 1.3.2021, të shtetasit M.Gj.** Denoncuesi parashtron se disa shtetas të përkrahur nga Bashkia, Prokuroria dhe Gjykata në vitin 2012 kanë pushtuar e shkatërruar pronën e tij. Për subjektin e rivlerësimit denoncuesi përmend faktin se ka kundërshtuar vendimin e procedimit penal datë 2.10.2018, por Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendim, ka rrëzuar ankimin duke lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë. Sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika apo ndonjë shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit për ta hetuar më tej.

35.8 Denoncim nr. * prot., datë 1.11.2019, i shtetasit A.S,** mbi procedimin penal nr. ***, viti 2010. Lidhur me këtë denoncim u kërkuar praktika përkatëse nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2023, kjo Prokurori ka theksuar se ky procedim penal nuk është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit Arben Agovi.

35.9 Denoncim nr. * prot., datë 24.11.2020, i shtetasit Gj.C.** Sipas denoncuesit, Prokuroria nuk është përpjekur të bëjë hetim të thelluar për të zbuluar dhe dokumentuar ekzistencën e një grupi të strukturuar kriminal. Në kallëzimin penal ky shtetas, ndër të tjera, ka shpjeguar në lidhje me tjetërsimin në kundërshtim me ligjin e parcelave shtetërore “ranishte” përgjatë bregut të detit në zonën e plazhit të fshatit ***, tek zona e quajtur ***, në Njësinë Administrative Sh, Bashkia Lezhë.

Për këtë denoncim iu kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2023, kjo Prokurori ka theksuar se procedimi penal nr. ***, datë 19.2.2021, është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Bëhet fjalë për procedimin penal nr. ***, viti 2019, mbi bazën e materialit hetimor të referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendorë të Policisë Lezhë, si dhe kallëzimit penal të A. P. C. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se përgjatë vitit 2016, Bashkia Lezhë ka dërguar për regjistrim në ZVRPP, sot ASHK Lezhë, dokumentacionin për pajisjen me tokë të shtetasve A. Ll. B. dhe Gj.D.B. Praktikën e dokumentacionit të dërguar nga Bashkia Lezhë përmbajnë aktin e marrjes së tokës në pronësi, vërtetimet e kufizimeve, konfirmimet e pasurive, planet e rievimit, si dhe certifikatën familjare të datës 1.8.1991.

ZVRPP Lezhë, pas administrimit të dokumentacionit ka konstatuar se sipërfaqet e pasurive nuk janë tokë bujqësore, por ranishte. Për këtë arsye, nga ZVRPP-ja Lezhë është kërkuar konfirmim për dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Lezhë duke iu drejtuar me shkresa përkatëse Bashkisë Lezhë dhe Këshillit të Qarkut Lezhë. Në vijim i kanë kthyer përgjigje ZVRPP-së ku, ndër të tjera, është konfirmuar se pasuritë janë të llojit arë. Pas marrjes së përgjigjeve, ZVRPP-ja ka proceduar me regjistrimin e këtyre pasurive ku, sipas dispozitave të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për

tokën”, si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, nuk duhej të procedonte me regjistrimin e këtyre dy pasurive.

Sipas akteve të ekspertimit tekniko-grafik ka rezultuar se dokumentacioni i pajisjes me tokë në emër të shtetasve A. Ll. B. dhe Gj. D. B. është i falsifikuar dhe nga ekspertimi topografik ka rezultuar se sipërfaqet e përfituara me dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Lezhë janë ranishte dhe jo tokë bujqësore (arë).

Pas një hetimi, referuar dy akteve të cituara më lart, prokurori ka shënuar në kolonën përkatëse të regjistrimit të procedimeve penale për procedimin penal nr. *** emrat e disa funksionarëve të lartë²⁰ dhe nëpunësve të administratës vendore dhe asaj qendrore në nivel vendor, si dhe shtetasit përfutës të dy pasurive për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186/2 dhe 186/3 të Kodit Penal. Referuar nenit 75/a, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Penale, në datën 19.2 2021 subjekti i rivlerësimit ka vendosur²¹ “Kalimin e akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2019, për shkak të moskompetencës lëndore, duke i kaluar aktet tek Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë”.

Lidhur me këtë çështje u konstatua se:

- Duket se subjekti ka kryer disa hapa hetimi, të cilat shkojnë përtej afatit kohor standard të kërkuar për hetim (3 muaj), pa iu referuar ndonjë akti të motivuar shtyrjeje të hetimit.
- Në aktin e transferimit të kësaj çështjeje rezulton që subjekti të ketë regjistruar emrat e personave, të cilëve u atribuohen veprat penale, pas disa hapave hetimorë. Në të njëjtin akt, këta persona cilësohen edhe nga subjekti si konsumues/kryer të krimeve në fjalë.
- Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë se kur i ka regjistruar emrat e të dyshuarve, si dhe të shpjegojë dhe të provojë nëse gjatë hetimit janë nxjerrë akte me motive shtyrjeje, duke qenë se çështja është regjistruar në vitin 2019 dhe ka kaluar në SPAK në shkurt 2021.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit parashtroi: *“Në lidhje me çështjen në fjalë janë kryer veprime të ndryshme hetimore dhe të një karakteri që lidhet me vendimmarrje gjyqësore, në bazë të kërkesës së Prokurorisë, që lidhen me vendosjen e sekuestros preventive të dy pasurive, kryerjen e ekspertimeve përkatëse grafik e topografik, marrje deklarimesh, administrim dokumentacioni, pra etapa hetimore të evidentuara dhe nga ana juaj. Pas arritjes së rezultateve hetimore dhe analizimit të çështjes hetimore, në një kohë që një çështje tjetër e këtij karakteri, e mëparshme, po me të njëjtin kallëzues, por me pasuri të tjera ishte në fazë gjykimi, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë u konkludua nga ana ime si prokuror i çështjes mbi ekzistencën e elementeve të figurave të veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe*

²⁰ Njëri prej tyre, F. F. ish-kryetar i Bashkisë Lezhë.

²¹ Neni 75/a, shkronjat “c” e “ç” të Kodit të Procedurës Penale përcaktojnë se Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: *“...c. Akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Anëtarit të këshillit të Ministrave, Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, Deputetit, Zëvendësministrit, Anëtarit të KLGJ-së dhe të KLP-së dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj. ç. Akuzat Penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të detyrës”.*

“Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186/2/3 dhe 248 të Kodit Penal, pikërisht nga ish-Kryetari i Bashkisë Lezhë dhe funksionarë të tjerë të pushtetit vendor dhe institucioneve të ndryshme, si dhe persona.

Ndaj në këto rrethana u procedua me përpilimin e urdhrit për regjistrimin e emrave të personave që u atribuohen veprat penale të lartpërmendura dhe në mbështetje të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale është vendosur kalimi i akteve Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, pas shpalljes së moskompetencës lëndore.

Nisur nga nënpikat e parashtruara nga ana e juaj, bëj me dije se duke qenë se nuk është proceduar që në krye të herës me regjistrimin e emrit/ve të personit/ve që t’u atribuohen veprat penale, nuk mund të procedohej me zgjatje të afatit të hetimeve, duke ia nënshtruar çështjen, kryerjes dhe rezultatit të veprimeve hetimore, të cilat janë të konsiderueshme, derisa është arritur në konkluzionin mbi ekzistencën e figurave të veprave penale konkrete dhe lëshimin e urdhrit për regjistrimin e emrave të personave që u atribuohen veprat penale, urdhër ky i datës 15.2.2021 dhe duke qenë se bëhej fjalë për ish-kryetarin e Bashkisë është proceduar me shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas vendimit të datës 19.2.2021, e cila e ka pranuar çështjen penale dhe në dijeninë time është proceduar me paraqitjen e kërkesës për dërgimin për gjyq të çështjes konkrete pranë Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Pra, nuk janë nxjerrë akte procedurale, vendim zgjatje të afatit të hetimeve nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për sa kohë që urdhri për regjistrimin e emrave të personave që u atribuohen veprat penale është nxjerrë pas rezultatit të veprimeve hetimore-procedurale dhe menjëherë është shpallur moskompetenca lëndore dhe kaluar aktet Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”.

Vlerësimi i Komisionit

Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë hetim penal nga ana e subjektit.

Në bazë të hetimit të tij dhe regjistrimit më pas të personave ndaj të cilëve ka filluar hetimi është bërë i mundur dërgimi dhe ndjekja e kësaj çështjeje penale pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

35.10 Denoncim nr. * prot., datë 10.9.2021, i shtetas P.P.** Denoncuesja pretendon se i është drejtuar prokurorisë për informacion në fazën ku ndodhen hetimet, por nuk ka marrë përgjigje. Lidhur me këtë denoncim i është kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2023, kjo Prokurori ka theksuar se kjo çështje penale është nën hetim.

Për këtë çështje iu rikërkua praktika Prokurorisë së Rrethit Lezhë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2023, paraqiti kopje të procedimit penal nr. ***, viti 2020.

Sipas kësaj praktike rezulton se prokurori Arben Agovi ka nxjerrë urdhër për regjistrimin e procedimit penal (bazuar në aktet e kallëzimit penal nr. ***, viti 2020) në datën 10.3.2020 mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasja P.P. Kallëzuesja ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasit D.V

për veprën penale “Mashttrim” të kryer në bashkëpunim me shtetasen L.P, si dhe për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” ndaj punonjësve të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë Lezhë.

Regjistrimi i procedimit është bërë nga subjekti i rivlerësimit për veprën penale “Mashttrim” të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, pa emër personi që i atribuohet vepra penale. Në datën 11.3.2020 është urdhëruar nga prokurori kryerja e disa veprimeve hetimore nga OPGJ-ja deri në datën 30.4.2020. Deri në këtë datë duket se janë kryer vetëm disa veprime hetimore (kryesisht shkresa për njoftim dëshmitarësh dhe deklarata nga personat që kanë dijeni për çështjen), kurse veprimet e tjera hetimore, sidomos komunikimet me institucionet shtetërore, duket se janë kryer përtej datës 30.4.2020.

Për këtë çështje, në përfundim të hetimit, subjekti, në datën 26.10.2020 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesë për “Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2020”. Kërkesa është bërë nga prokurori pas relacionit të OPGJ-së datë 22.10.2020 “Për mënyrën e përfundimit të procedimit penal nr. ***, viti 2020”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. ***, datë 17.12.2020²², ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë.
- Kthimin e akteve.
- Detyrimin e Prokurorisë për vazhdimin e hetimeve që duhet të përfundojnë brenda afatit 3-mujor.

Pas këtij vendimi nuk rezulton në dosjen e sjellë nga Prokuroria ecuria e mëtejshme e kësaj çështjeje dhe zbatimi i detyrave të lëna nga Gjykata.

Komisioni për këtë çështje arriti në përfundimin se:

- Subjekti duhet të japë shpjegim lidhur me shkaqet dhe argumentet e paraqitura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për kthimin e kërkesës së tij për pushimin e hetimit.
- Duket se subjekti ka regjistruar procedimin penal për kallëzimin për veprën penale “Mashttrim” pa referuar emrin e personit konkret për të cilën ka filluar ndjekja penale.
- Duket se subjekti nuk ka kryer veprimet hetimore dhe përfundimin e tyre brenda afatit të caktuar nga vetë ai.
- Duket se subjekti nuk ka nxjerrë akte të tjera procedurale për vazhdimin e hetimit duke përcaktuar edhe afate të tjera kohore.
- Duket se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim lidhur me marrjen e dëshmisë së personit të akuzuar për veprën penale “Mashttrim”.
- Duket se subjekti nuk ka regjistruar dhe nuk ka ndjekur hetime lidhur me veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” ndaj punonjësve të ZVRPP-së Lezhë.

²² Për më tepër dhe lidhur me shkaqet e kthimit të çështjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, referojuni vendimit nr. ***, datë 17.12.2020 të saj.

- Subjekti duhet të japë shpjegime të hollësishme lidhur me ecurinë e kësaj çështjeje pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për kthimin e kërkesës së tij.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit shpjegoi: *“Gjatë hetimeve është proceduar me marrjen e deklarimeve përkatëse në cilësinë e personit që tregojnë rrethana të hetimit shtetases L.P, nga deklaratimet e së cilës konstatohej se vëllai i saj D.V i kishte marrë një shumë parash prej 4.800.000 lekësh, me qëllim blerjen e një apartamenti.*

*Gjykata, në vendimin e saj nr. ***, datë 17.12.2020, shprehet se Prokuroria duhet të hetojë se përse në kohën e acarimit të marrëdhënieve mes çiftit të bashkëshortëve D.V dhe P.P (V) është lidhur kontrata e shitjes së apartamentit në fjalë më 6.6.2011. Në këtë pikë vlen të përmendet fakti se e përsërisim që kontrata e shitblerjes i përket datës 6.6.2011, ndërkohë që me vendimin e datës 21.6.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, padisë me objekt lëshimin e urdhrat të mbrojtjes ku, vetë shtetasja P.V, ka kërkuar pushimin e çështjes, pasi nuk ka një situatë të tillë aktualisht; ndërkohë që në një rast tjetër për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, sërish ka vendosur pushimin e çështjes, në bazë të kërkesës së vetë paditëses P.V , por jo ndaj bashkëshortit të saj, por ndaj kumatit të saj. Ndërkohë më 6.10.2011 nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë është vendosur zgjidhja e martesës.*

*Gjatë fazës së hetimeve janë marrë deklaratimet e shtetases P.P , e cila shprehet se pas marrjes formë të prerë të vendimit, përmes përmbaruesit gjyqësor privat B.M ka kërkuar ekzekutimin e vendimit që lidhet me dërgimin e vendimit nr. ***, datë 27.2.2017, pas marrjes formë të prerë të tij për veprime pranë ZVRPP-së Lezhë dhe, kështu, është vepruar nga ana e përmbaruesit gjyqësor privat duke proceduar me vendimin për kalim në ekzekutim të detyrueshëm datë 30.5.2019 për ZVRPP-në Lezhë dhe më 24.7.2019 ka vendosur pushimin e ekzekutimit. Pra, nga ana e ZVRPP-së Lezhë janë kryer veprimet në bazë të kontratave të shitjeve mes palëve, ndërkohë që vendimi gjyqësor është dërguar ai i formës së prerë, ashtu sikurse është shprehur Gjykata.*

*Në lidhje me çështjen, vlerësimi im si prokuror i çështjes në përpilimin e kërkesës është bërë në bazë të hetimeve të kryera, ndërkohë ajo çka ka vlerësuar Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë në vendimin e saj nr. ***, datë 17.12.2020, janë pas marrë në konsideratë duke arritur në konkluzion të kërkesës për pushimin e çështjes, ndërkohë që sa më sipër paraqitëm një shpjegim të atyre momenteve që Gjykata në vendimin e saj nr. ***, datë 17.12.2020, pati vlerësuar, ku sidoqoftë është gjyqtari i seancës paraprake ai që e shqyrton çështjen në mbështetje të nenit 329/b të Kodit të Procedurës Penale.*

*Çështja ka nisur mbi bazë kallëzimi penal të shtetases P.P dhe ku gjatë fazës së verifikimeve janë ndërmarrë veprimet për kryerjen e verifikimeve të kallëzimit penal nr. ***, datë 24.2.2020, ndërkohë që shtetasi D.V nuk rezultonte të ndodhej në Shqipëri dhe brenda afatit ligjor më 10.3.2022 është proceduar me regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Mashttrim” të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, ku gjatë hetimeve do të konkludohej nëse ndodheshim para elementeve të figurës së veprës penale dhe, nëse po, para regjistrimit të emrit të personit që do t'i atribuohet kjo veprë penale, apo në rast të ekzistencës së veprave të tjera penale dhe personave konkretë.*

Sa i takon nënplikës lidhur me veprimet hetimore të kryera në afatin përkatës, është i vërtetë fakti se pas regjistrimit të procedimit penal është urdhëruar policia gjyqësore në Prokurori për kryerjen e veprimeve përkatëse, duke lënë afatin përkatës datë 30.4.2020, veprime të cilat rezultojnë të mos jenë kryer të gjitha në këtë afat të lënë policisë gjyqësore, ndërkohë që është urdhëruar në vazhdimësi verbalisht policia gjyqësore për kryerjen e detyrave të lëna apo edhe të tjera që do të dilnin sikurse dhe ishte urdhëruar të vepronte.

Sa i takon nënplikës lidhur me dukjen mbi moskryerjen e hetimeve lidhur me veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” ndaj punonjësve të ZVRPP-së Lezhë, bëj me dije se që në momentet e para të kryerjes së verifikimeve të kallëzimit penal, pa u regjistruar çështja si procedim penal është kërkuar informacioni dhe dosja konkrete, pra praktika, ZVRPP Lezhë, dhe duke qenë se kjo praktikë nuk u soll në ato momente, fakt ky i pasqyruar edhe në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, është rikërkuar sipas urdhrin të dhënë nga ana e policisë gjyqësore, praktika përkatëse ZVRPP Lezhë, të cilët gjatë fazës së hetimeve e kanë dërguar praktikën”.

Vlerësimi i Komisionit

Rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka kthyer për hetim këtë çështje pranë Prokurorisë, pasi subjekti duhet të hetonte edhe veprimet mes shtetasve D.V dhe L.P ndaj shtetasës P.V (P).

Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me hetimet e kryera, si dhe me mosfillimin e procedimit për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, por nuk ka shpjeguar bindshëm pse nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore para se çështjen ta dërgonte në gjykatë për pushim. Detyrat e lëna ndaj oficerit të policisë gjyqësore nuk verifikohen plotësisht pasi edhe sipas subjektit janë lënë verbalisht.

Për këtë çështje është vazhduar më tej hetimi nga Prokuroria e Rrethit Lezhë, pasi subjekti është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

35.11 Denoncim nr. * prot., datë 4.10.2021, i shtetasit F.C.** Denoncuesi pretendon për zvarritje të procesit mbi 2 vite. Lidhur me këtë denoncim i është kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2023, kjo Prokurori ka theksuar se kjo çështje penale është nën hetim.

Për këtë çështje iu rikërkua praktika Prokurorisë së Rrethit Lezhë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2023, paraqiti kopje të procedimit penal nr. ***, viti 2019.

Sipas kësaj praktike rezulton se prokurori Arben Agovi ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 18.7.2019, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi F.C, duke caktuar detyra për oficerin e policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Lezhë. Regjistrimi i procedimit është bërë për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Në datën 25.7.2019 është nxjerrë urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore-procedurale pas studimit të akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2019 (bazuar në kallëzimin penal nr. ***, viti 2019). Ky urdhër përcakton kryerjen e disa veprimeve të mëtejshme hetimore procedurale²³ deri më 20.11.2019 (për shkak edhe të sezonit të pushimeve). Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Lezhë nuk janë dërguar materiale të tjera hetimore për këtë çështje penale dhe nuk dihet ecuria e hetimit të kësaj çështjeje pas datës 20.11.2019. Rezultoi se në datën 27.4.2021, me shkresën nr. *** prot.

²³ Shihni pjesën urdhëruese të urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore-procedurale të datës 18.7.2019.

(A. A.), subjekti i rivlerësimit i ka komunikuar denoncuesit F. C se: *“Kjo çështje penale është akoma në hetim, nisur kjo nga korrespondenca me institucionet e tjera, e ndikuar kjo edhe nga pandemia Covid-19, duke përbërë ky, gjithashtu një shkak të lidhur me ecurinë e hetimeve, pa dashur të kapemi pas kësaj situatë, sidoqoftë problematikave, në çdo aspekt”*.

Nisur nga fakti i mungesës së dokumentacionit të plotë për këtë çështje nga ana e Prokurorisë si çështje ende në hetim, Komisioni i kërkoi shpjegime të hollësishme subjektit të rivlerësimit lidhur me hapat hetimorë të ndjekur prej tij, hetimet e kryera, vonesat dhe zgjatjet e hetimeve për këtë çështje (kërkesa për zgjatje dhe miratimet përkatëse) edhe pas kalimit të afatit 2-vjeçar nga regjistrimi i saj.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti shpjegoi se: *“Nga praktika rezulton të jetë regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 18,07.2019, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, ku është proceduar me lëshimin e urdhrit për kryerjen e veprimeve hetimore-procedurale. Në dijeninë time nga ana e policisë gjyqësore janë kryer veprime në lidhje me kërkimin e dokumentacionit përkatës, administrimin e dokumentacionit posedues prej shtetasit F.C , dokumentacion voluminoz, që kërkonte kohën përkatëse për verifikim, ndërkohë që kujtoj se nga takimet me policinë gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë për këtë çështje kishte problematikë, vonesë, sa i takon posedimit të dokumentacionit arkivor dhe verifikimit të situatës së pretenduar nga kallëzuesi, për shkak të volumit dokumentar, si dhe periudhës kohore për të cilën bëhej fjalë. Ndërkohë në vazhdimësi është urdhëruar policia gjyqësore për kryerjen e detyrave të tjera përkatëse, të lëna në urdhër. Ndërkohë është njoftuar shtetasi F.C , ku i është bërë me dije gjendja mbi ecurinë e hetimeve.*

Nuk rezulton të jetë proceduar me zgjatje afatesh hetimore, për sa kohë nuk është proceduar me regjistrim emri personi/ash që t’u atribuohet vepra penale, ndërkohë që deri në momentin që jam transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në bazë të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, çështja nuk ishte përfunduar”.

Vlerësimi i Komisionit

Shpjegimet e paraqitura për këtë rast nga subjekti nuk janë bindëse dhe qëndrojnë gjetjet e Komisionit në rezultatet e hetimit. Subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit lidhur me vonesat dhe zgjatjet e hetimeve për këtë çështje edhe pas kalimit të afatit 2-vjeçar nga regjistrimi i saj.

35.12 Denoncim anonim nr. * prot., datë 18.1.2022.** Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar në kundërshtim me ligjin shtetasin A.R (i cili nuk jeton më), në masën e dënimit, i cili ka qenë i akuzuar për dy vepra penale “Vjedhje” dhe “Prodhimi dhe shitja së narkotikëve”.

Pavarësisht se ka qenë i akuzuar për dy vepra penale, prokurori Arben Agovi ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit për pjesën e mbetur duke kërkuar dënimin e tij me kusht dhe jo me burg për shkak të rrezikshmërisë së lartë që ai paraqiste. Denoncuesi vazhdon denoncimin e tij duke sqaruar se shtetasi A. R. brenda kohës së dënimit me kusht ka vrarë shtetasin S. H. (i ndjeri, ish-agjent policie). Gjithashtu, përveç kësaj, shtetasi A. R. arriti që brenda kushtit të dhënë të bëjë edhe një tjetër vepër penale për të cilën u arrestua dhe më pas doli përsëri dhe vrau shtetasin S. H.

Bashkëlidhur denoncimit gjendet vendimi nr. ***, datë 3.18.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për nevoja hetimi të mëtejshme, me qëllim identifikimin e këtij rasti në aspektin e rivlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, i kërkoi²⁴ Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë kopje të dosjes së procedimit penal nr. ***, viti 2018, e cila në përgjigjen nr. *** prot., datë 27.9.2023, ka sjellë kopjen e plotë të dosjes së këtij procedimi penal, si dhe kopje të *diskutimit përfundimtar* të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të kësaj çështjeje ndaj të pandehurit A. R.

Nga dokumentacioni vërehet se prokurori Arben Agovi ka hetuar çështjen në ngarkim të të pandehurit A. R., i cili është akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vjedhje” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” në formën e mbajtjes, të parashikuara nga nenet 134/1 e 283/1 të Kodit Penal, ndërkohë që është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Lezhë mbi pushimin e hetimeve lidhur me veprën penale “Nxitja për përdorimin e drogës”, sipas nenit 286/1 të Kodit Penal. Ky procedim është regjistruar në bazë të materialit referues nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë ndaj të njëjtit person për veprat penale, sipas neneve 283/1 dhe 286 të Kodit Penal.

Shtetasja (e dëmtuara) A. S. ka bërë kallëzim penal para policisë gjyqësore ndaj shtetasit A. R., të dy me banim në Lezhë, duke e akuzuar atë për vjedhjen e aparatit celular, shumës prej 50 euro, si dhe deklarimit të saj në lidhje me detyrimin e konsumimit të cigareve me lëndë narkotike. Janë kryer veprimet hetimore të nevojshme nga ku ka rezultuar se nga kontrolli i banesës së të pandehurit është gjetur lëndë *cannabis sativa*. Nga këqyrja e shtetasës A. S. ka rezultuar se ajo ka dëmtime trupore, për shkak të rrahjes dhe dhunës së ushtruar nga i pandehuri me mjete të forta mprehëse, si dhe ka rezultuar prania e lëndëve narkotike në organizmin e saj (nga kryerja e ekspertimit toksikologjik). Referuar deklarimeve të personave të dëmtuar dhe atyre që kanë dijeni ka rezultuar ndër të tjera se nëna e të dëmtuarës A. S. ka deklaruar përpara policisë gjyqësore se A. R. ka vepruar negativisht ndaj të bijës duke i thyer telefonin, syzet, duke e rrahur, si dhe duke e shtyrë të pijë hashash.

Në përfundim prokurori ka kërkuar deklarimin fajtor të pandehurit A. R. për kryerjen e veprave penale “Vjedhje” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” në formën e mbajtjes, të parashikuara nga nenet 134 e 283/1 të Kodit Penal, duke kërkuar dënimin e tij me 5 vite burgim e në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (gjkimit të shkurtuar) dënimin me 3 vite e 4 muaj burgim.

Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit për pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit duke e lënë me kusht për një afat 1 vit e 8 muaj.

²⁴ Shihni shkresën me lëndë “Kërkesë për informacion dhe dokumentacion”, me nr. *** prot., datë 7.9.2023.

Në përfundim të hetimeve, Komisioni konstatoi si vijon:

- Referuar veprave penale për të cilat është ngritur dyshimi se shtetasi A. R. i ka kryer ato, prokurori ka kërkuar pushimin për njëri prej tyre, atë të “Nxitja për përdorimin e drogës”, sipas nenit 286/1 të Kodit Penal, ndërkohë që duket se Gjykata e ka pranuar këtë kërkesë të prokurorit.
- Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka kërkuar në përfundim të hetimeve deklarimin fajtor të të pandehurit A. R., por ai ka kërkuar aplikimin e dënimit alternativ siç është dënimi me kusht, duke e zëvendësuar dënimin përfundimtar me 3 vite e 4 muaj burgim me atë 1 vit e 8 muaj me kusht.
- Sa më sipër, Komisioni vlerësoi se në aspektin e vlerësimit të aftësive të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket aspektit procedural të hetimit të dosjes në ngarkim të shtetasit A. R. subjekti nuk mund të kërkonte pushimin e hetimit për veprën penale të parashikuar nga neni 286/1 i Kodit Penal, për sa kohë ka rezultuar e provuar se kjo vepër penale është kryer nga i pandehuri.
- Në vlerësim të rrethanave lehtësuese e rënduese në dokumentin “Diskutim përfundimtar”, nga ana e subjektit të rivlerësimit drejtuar Gjykatës vërehet se ai nuk i ka baraspeshuar në mënyrë të drejtë e proporcionale këto rrethana të ngjarjes, duke kërkuar dënim alternativ, më të lehtë për një person me rrezikshmëri të lartë shoqërore.
- Gjithashtu, referuar masës së dënimit alternativ/dënimit me kusht nëpërmjet vënies në provë prej 1 viti e 8 muaj, të kërkuar nga prokurori, është dënim i ulët në raport me dënimin me burgim prej 3 viti e 4 muaj, kjo referuar pikës 4 të nenit 59 të Kodit Penal, ku thuhet se *masa e dënimit alternativ/me kusht duhet të jetë 24 muaj deri në 5 vite*. Duket si nonsens ligjor që dënimi me kusht të jetë më i vogël se dënimi me burgim.
- Duket se subjekti nuk ka hetuar plotësisht dhe ndjekur penalisht të pandehurin A. R. për veprat penale “Shtrengimi me anë të kanosjes” dhe “Dhuna dhe nxitja për përdorimin e drogës”, të bërë ndaj shtetasit A. S., si dhe nuk ka kërkuar masën e dënimit në përputhje me ligjin penal.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit parashtroi: *“Nuk rezulton të provohet se shtetasi A.R të ketë konsumuar veprën penale “Nxitja për përdorimin e drogës”, parashikuar nga neni 286/1 i Kodit Penal, pavarësisht se shtetasja A.S ka shpjeguar se ka qenë shtetasi A.R ai që ka ndikuar në vullnetin e saj pa pëlqimin e saj, për të përdorur lëndën narkotike të llojit cannabis (hashash). Ndërkohë rezulton të jemi para deklarimeve të shtetasit A.R që nuk e pranon faktin që i atribuohet nga shtetasja A.S . Pra, jemi së pari para deklarimeve të kundërta. Ndërkohë sikurse rezulton edhe nga deklaratimet e shtetasit A.S , nuk rezulton që shtetasja A.S , që në momentet e para të mospëlqimit të saj për të provuar lëndën narkotike, gjithmonë sipas deklaratimeve të saj, të kishte treguar në radhë të parë njerëzve tek të cilët ajo kishte besim për t’u drejtuar më pas pranë organeve të rendit publik, duke përfshirë shërbimet policore apo organet e Drejtësisë, pavarësisht se shtetasja A.S ka bërë kallëzim penal me datë 29.7.2018, ku janë parashtruar në kallëzimin e deklaratimet e saj shkaqet që e kanë shtyrë të bëjë kallëzimin penal ndaj shtetasit A.R . Rezulton se kjo situatë që shprehet shtetasja A.S në kuptim të nenit 286 të Kodit Penal nuk është situatë që është krijuar në një ditë dhe ka zgjatur një ditë, gjithmonë sipas pretendimeve të shtetasit A.S , por po sipas këtyre pretendimeve kjo ka ndodhur dhe ka zgjatur me muaj dhe ndaj duhej proceduar*

më parë me qëllim kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore procedurale, me qëllim provueshmërinë e kësaj vepre penale, gjithmonë nga A.R . Ndërkohë, sikurse jemi pas shprehur, pa rënë në përsëritje kemi edhe deklarime të tjera, sikurse janë deklarimet e shtetasit L.R , ndonëse është i afërmi i shtetasit A.R dhe patjetër që mund të mendohet se do të mbrojnë interesat e të afërmit të tij, ndërkohë që ai ka dhënë deklarime duke i bërë me dije nenin 158 të Kodit të Procedurës Penale, gjithmonë në lidhje me elementet që parashikon vepra penale sipas nenit 286 të Kodit Penal, ku shprehet se në çdo kohë deri në ditën e fundit ai ka konstatuar që marrëdhëniet mes shtetasve A.R dhe A.S kanë qenë krejt normale, në një lidhje normale e madje të qeshur me njëri-tjetrin, ndërkohë që deklaroi se i ka parë të dy personat në fjalë, duke tymosur pa përcaktuar faktin nëse po tymosnin lëndë narkotike apo dhe deklarimet e shtetasit K.Sh, i cili deklaroi se shtetasja A.S , pra e dashura e shtetasit A.R , tymoste cigare, por me një erë më të rëndë se kjo e fundit, gjithmonë e pasugjestionuar nga prania e personave të tjerë të pranishëm, ashtu sikurse edhe në banesën e tij, ditën në fjalë, nuk ka dëgjuar e parë që shtetasi A.R të ketë ndikuar tek shtetasja A.S për të tymosur, por i vetmi moment i situatës së vështirë mes atyre personave, A.R e A.S , lidhej me aparatën telefonik, derisa ky shtetas ka ndërhyrë dhe më pas të gjithë personat janë larguar nga shtëpia e tij në B dhe gjatë rrugës nuk kanë komunikuar më tej.

Pra, përfundimisht, pavarësisht se procedimi penal ndaj shtetasit A.R është regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 134/1 dhe 283/1 të Kodit Penal, vepra për të cilat është akuzuar, dhe për këto akuza u paraqit kërkesa në Gjykatë, për dërgimin në gjyq të çështjes ndaj të pandehurit A.R , ndërkohë që sikurse është vepruar në momentet e para të regjistrimit është regjistruar dhe për veprën penale të parashikuar nga neni 286 i Kodit Penal, ku rezulton se nuk provohet që shtetasi A.R të kishte konsumuar këtë vepër penale, pavarësisht deklarimeve të shtetasve A.S , ndërkohë që çështja i ishte nënshtruar hetimit në tërësinë e saj.

Në mbështetje të neneve 328, pika 1, shkronja “dh” e Kodit të Procedurës Penale del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet se e ka kryer, sa i takon veprës penale “Nxitja për përdorimin e drogës”, sipas nenit 286/1 të Kodit Penal. Kërkesa me objekt “Dërgimin në gjyq të çështjes penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 134/1 dhe 283/1 të Kodit Penal” dhe “Pushimin e çështjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 286/1 i Kodit Penal”, është paraqitur para Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ku gjyqtari i seancës paraprake e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë, ku e pranishme në seancën paraprake ka qenë edhe shtetasja A.S dhe, konkretisht, për rastin konkret... Pushimin e çështjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 286/1 i Kodit Penal.

Nga të dhënat konkrete nuk na rezultonte të gjendeshim para një personi me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në atë kohë, e konstatuar kjo edhe nga ana e Gjykatës që ka vendosur deklarinin fajtor e dënuar shtetasin, të pandehur, A.R , duke aplikuar dënimin alternativ.

Ndërkohë nga hetimet e kryera nuk ka rezultuar të jemi gjendur para veprës penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, sipas nenit 109/a të Kodit Penal, pasi ka rezultuar se situata e ndodhur mes shtetasve A.R dhe A.S , në shtëpinë ku shkuan në B, Lezhë, nuk ndodhi për shkak të marrjes së telefonit send që i përkiste shtetasve A.S , por për shkak të “xhelozisë” që i ka shfaqur shtetasi A.R shtetasve A.S , për ato që kishte apo pretendonte më saktë ai person, në rubrikat e telefonit të saj celular, sms (mesazhe), duke i kërkuar me ngulm të hapte

telefonin, i cili hapej vetëm me shenjën e gishtit të saj dhe këtë e ka deklaruar edhe vetë shtetasja A.S dhe personi i pranishëm aty, pra personi që e kishte shtëpinë, i cili ka ndërhyrë sikurse rezultoi nga deklaratimet.

Sikurse është arsyetuar në kërkesën përkatëse, sa i takon veprës penale “Vjedhje”, sipas nenit 134/1 të Kodit Penal dhe konkluduar edhe në vendimin gjyqësor, shtetasi A.R është akuzuar dhe dënuar për veprën penale sipas nenit 134/1 të Kodit Penal, pasi ka përvetësuar një send shtetases A.S, në rastin konkret, aparatit e saj celular, pa dëshirën e vullnetin e saj, duke e privuar nga e drejta e pronësisë dhe posedimit të lirshëm mbi sendin e saj”.

Vlerësimi i Komisionit

Subjekti ka dhënë shpjegime të plota lidhur me hapat proceduralë të ndjekur, hetimin e kryer, si dhe vlerësimin e bërë në tërësi për këtë çështje. Por Komisioni shprehet se mund të ishte vlerësuar me mirë nga ana e subjektit procedimi penal për sa i takon veprës penale “Nxitja për përdorimin e drogës”.

Por kjo çështje dhe hetimi i kryer është vlerësuar nga Gjykata, e cila ka vendosur në prani të palëve se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet se e ka kryer, sa i takon veprës penale “Nxitja për përdorimin e drogës”, sipas nenit 286/1 të Kodit Penal.

Dënimi alternativ është dhënë nga Gjykata për shtetasin A. R., për shkak se nga të dhënat nuk rezultonte se gjendeshin para një personi me rrezikshmëri të lartë shoqërore në atë kohë.

35.13 Denoncim anonim nr. * prot., datë 27.1.2022.** Ky denoncim është paraqitur pranë Komisionit nga oficeri i burgut. Sipas denoncuesit anonim, subjekti Arben Agovi është i korruptuar, pasi çdo vërtetim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka lëshuar kundrejt korrupsionit, ashtu siç ka mbyllur edhe shumë dosje. Për këtë denoncuesi jep edhe *link*-un dhe tekstin e publikuar nga një emision televiziv. Në përmbajtje të tekstit përmendet se prokurori Arben Agovi ka përfituar në mënyrë korruptive shumë prej 500 euro. Çështjet e pretenduara janë në kuadrin e hetimit penal dhe nuk ka *indicie* për të vlerësuar ndonjë çështje të ndjekur nga subjekti. Në këtë aspekt, Komisioni vendosi moshetimin e mëtejshëm administrativ për këtë denoncim.

35.14 Kërkesë e shtetasit A.S, e datës 11.7.2020

Sipas denoncuesit, subjekti i rivlerësimit ka kryer vonesa në hetim dhe veprime të kundërligjshme. Për këtë çështje iu kërkua praktika Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2023, paraqiti kopje të procedimit penal nr. *** të vitit 2019.

Nga praktika rezultoi se prokurori Arben Agovi, në datën 10.6.2019 ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal (kallëzimi penal nr. *** i vitit 2019) pas administrimit të akteve të kallëzimit penal nr. ***, datë 27.5.2019, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Ky regjistrim i procedimit penal është bërë pa emër personi të regjistruar që t’i atribuohet vepra penale.

Kallëzimi penal është bërë nga shtetasi A.S ndaj ZVRPP-së Lezhë, Bashkisë Lezhë, shtetasve P, Gj dhe Gj.P, për veprat penale të parashikuara nga neni 186, 248, 84/320 e 199/a1/a2 të Kodit Penal. Sipas kallëzuesit këta të akuzuar kanë kryer veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin, si dhe falsifikim dhe tjetërsim prone.

Në datën 14.6.2019 është nxjerrë urdhri për kryerjen e disa veprimeve hetimore procedurale nga OPGJ-ja deri në datën 20.7.2019. Në datën 5.6.2019 është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale (kallëzuesi A.S). Në datën 6.6.2019 është mbajtur procesverbal për këqyrje dhe marrje të provave materiale. Gjatë kësaj periudhe kohore (5.6.2019 – 20.7.2019) janë kryer disa veprime hetimore dhe korrespondenca me institucione të ndryshme, hetime të cilat kanë vazhduar përgjatë vitit 2019.

Në datën 16.4.2020, subjekti ka bërë kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2019 (dërguar gjykatës me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2020). Për këtë kërkesë, për pushimin e hetimeve ka njoftuar edhe kallëzuesin A.S në datën 29.4.2020. Në kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***, subjekti ka renditur faktet dhe hetimin e kryer, duke pasqyruar edhe argumentet për pushimin e hetimeve të procedimit penal. Kjo kërkesë është mbështetur në nenin 328/1, shkronja “b”, si dhe nenin 329 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin e datës 21.10.2020, ka vendosur:

- Kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2019.
- Kryerjen e hetimeve për procedurën e ndjekur nga ZVRPP-ja Lezhë në regjistrimin e pasurisë së paluajtshme dhe kryerjen e një akti të ri të ekspertimit teknik.
- Të kryhen veprime të tjera hetimore brenda afatit 4-mujor.

Nga verifikimi i praktikës duket se ky afat 4-mujor i caktuar nga gjykata nuk është respektuar nga subjekti i rivlerësimit për mbylljen e hetimit.

Në datën 11.2.2021, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Lezhë ka vendosur bashkimin e çështjes nr. *** të vitit 2019 me çështjen nr. *** të vitit 2020, duke ngarkuar subjektin e rivlerësimit për hetimin e këtij procedimi. Subjekti ka kryer disa veprime hetimore, më pas çështja është ndjekur nga prokurori S. K, siç duket për shkak të transferimit të subjektit të rivlerësimit në Prokurorinë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë (transferimi duket në datën 27.4.2021).

Në përfundim të hetimit, Komisioni doli me konstatimet si vijon, për të cilat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime lidhur me:

- Shkaqet dhe argumentet e paraqitura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për kthimin e kërkesës së tij për pushimin e hetimit.
- Kryerjen e hetimeve të plota dhe shteruese për këtë çështje.
- Respektimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (vendim i datës 21.10.2020) për mbylljen e afatit të hetimit për këtë çështje brenda 4 muajve.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se: “Në bazë të kallëzimit penal të shtetasit A.S është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 10.6.2019, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, pa emër personi/ash, që t’u atribuohen veprat penale konkrete, me qëllim të mëtejshëm kryerjen e hetimeve dhe analizimin e tyre për të konkluduar mbi çështjen konkrete.

Për këtë çështje janë kryer veprimeve hetimore përkatëse, ku një ndër këto detyra ishte marrja e informacionit përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë, si dhe është proceduar me marrjen e deklarimeve në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethana të dobishme për hetimin shtetases A.Gj, me detyrë specialiste regjistrimi që nga 11.12.2015 deri më 7.10.2019 në ish-ZVRPP-në Lezhë.

Duke qenë se nga ana e ZVRPP-së Lezhë është sqaruar mënyra e regjistrimit e përshkruar me detaje nga ana e specialistes përkatëse, e pasqyruar dhe në dokumentacionin përkatës, kjo situatë është parashtruar para Gjykatës) dhe kjo lidhej me aplikimin për regjistrimin e pasurisë, ku është proceduar me dorëzimin e dokumentit të regjistrimit që figuron i regjistruar në regjistrat hipotekorë.

Rezultonte se ishte paraqitur plani i rilevimit të pasurisë, deklaratat noteriale e pronarëve kufitarë, dokumentacioni nga Arkivi Teknik i Ndërtimit i dhënë nga Instituti i Gjeografisë dhe i Infrastrukturës Ushtarake, fragment harte që disponohej në Drejtorinë e Urbanistikës së Lezhës, si dhe fleta e regjistrit që ndodhej në Arkivin Vendor të Qarkut Lezhë.

Duke qenë se ishte konkluduar se dokumentacioni ishte në përputhje me përcaktimet ligjore ishte bërë regjistrimi i pasurisë, regjistrim i realizuar në zbatim të Vendimit të KM-së me nr. 475, datë 24.10.2012, pika 4.

Ndërkohë, Gjykata ka kërkuar hetimin pikërisht mbi faktin e hetuar nga ana e Prokurorisë lidhur me çështjen konkrete, duke parashtruar verifikimin e disa pikave të tjera (të aspektit tekniko-administrativ) po të VKM-së përkatëse.

Gjithashtu, nga ana e Gjykatës është vendosur kryerja e riekspertimit sipas orientimit përkatës, nisur pikërisht nga kërkesa e përfaqësuesit të kallëzuesit në seancë gjyqësore, në një kohë që gjatë hetimeve, pavarësisht relacionit të oficerit të policisë gjyqësore mbi përfundimin e hetimeve, nga ana ime si prokuror u procedua pas analizimit të hetimeve përkatëse me këqyrjen e vendit për të cilin bënte fjalë kallëzuesi dhe më tej me kryerjen e ekspertimit tekniko-topografik.

Rezulton se nga ana e Gjykatës nuk është konstatuar i pavlefshëm akti i ekspertimit tekniko-topografik, por nisur nga parashtrimet në Gjykatë, nga kjo e fundit është vendosur kryerja e riekspertimit përkatës.

Vendimi gjyqësor është administruar nga Sekretaria e Prokurorisë, me datë 17.12.2020, dhe nga ana ime si prokuror i çështjes, duke qenë se nuk është ushtruar e drejta e ankimit ndaj vendimmarrjes konkrete dhe duke qenë se nga ana e Gjykatës janë dhënë orientimet përkatëse, është shënuar në fletën e shkresës përcjellëse së lartpërmendur të Gjykatës dhe, konkretisht, është urdhëruar nga ana ime si prokuror i çështjes oficerja e policisë gjyqësore në Prokurori për kryerjen e të gjithë detyrave sipas orientimit të lënë nga Gjykata.

*Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është vendosur bashkimi i procedimeve penale nr. ***, viti 2019 dhe nr. ***, viti 2020, në një procedim penal të vetëm sipas vendimit përkatës të datës 11.2.2021. Pavarësisht se nga ana ime si prokuror është urdhëruar policia gjyqësore për kryerjen e detyrave të lënë nga ana e Gjykatës, pas analizave të kryera në lidhje me çështjen konkrete me Policinë Gjyqësore është proceduar nga unë si prokuror me marrjen e vendimit për administrimin e dokumentacionit përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Lezhë, duke ngarkuar Policinë Gjyqësore në Prokurori dhe dërguar ky vendim agjencisë në fjalë për përgatitjen e materialit përkatës, voluminoz ky për disa pasuri, dhe i administruar pas një muaji nga ana e Policisë Gjyqësore pas përgatitjes së praktikave referente nga ana e agjencisë. Administrimi i këtij dokumentacioni ishte i nevojshëm për kryerjen e veprimeve konkrete sipas detyrave të lëna nga ana e Gjykatës. Ndërkohë, unë jam transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë e çështja ka kaluar tek një prokuror tjetër, ku në përfundim është vendosur pushimi i çështjes nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, vendim ky i cili ishte ankimuar”.*

Vlerësimi i Komisionit

Në këtë rast vërehet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota dhe ka dërguar në Gjykatë çështjen për pushim hetimi për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila me vendimin nr. ***, datë 21.10.2020, ka vendosur “Kthimin e akteve prokurorisë dhe vazhdimin e hetimeve duke lënë detyra konkrete”, kryesisht hetim lidhur me procedurën e ndjekur nga ana e ish-ZVRPP-ja Lezhë sipas orientimit përkatës dhe kryerjen e riekspertimit teknik sipas orientimit përkatës, si dhe veprime të tjera hetimore që do të rezultojnë të nevojshme, duke lënë një afat 4-mujor për kryerjen e këtyre veprimeve.

Ky vendim i Gjykatës nuk është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili duket se ka qenë dakord me vendimmarrjen e gjykatës. Gjithashtu, subjekti nuk ka dhënë argumente dhe shpjegime bindëse pse nuk janë realizuar detyrat e caktuara nga Gjykata brenda 4 muajsh, si dhe pse nuk është kërkuar në gjykatë zgjatja e hetimeve nëse kishim të bënim me hetime të mëtejshme edhe pas këtij afati.

35.15 Kërkesë e shtetases G.L, e datës 31.8.2020

Kjo kërkesë i është drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijeni edhe Komisionit. Denoncuesja ankohet për veprimet dhe mosveprimet e Prokurorisë së Rrethit Lezhë, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit në çështjen e vrasjes së bashkëshortit të saj D. L. dhe kërkon revokimin e vendimit të pezullimit të hetimit.

Për këtë çështje iu kërkuar praktika Prokurorisë së Rrethit Lezhë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2023, paraqiti kopje të procedimit penal nr. *** të vitit 2016.

Nga praktika rezulton se prokurori Arben Agovi ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, në datën 2.1.2016, për veprat penale “Vrasje me paramendim” dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të gjahut dhe sportive”, të parashikuara nga nenet 78/1 dhe 280 të Kodit Penal.

Në datën 15.2.2016, subjekti ka nxjerrë urdhrin “Për regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale”, që është shtetasi P. G.

Me vendimin e datës 21.4.2016 të Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Lezhë është bërë zëvendësimi i subjektit me prokurorin E. Sh, pas kërkesës së bërë nga shtetasja G.L .

Deri në momentin e zëvendësit të subjektit, nga ana e tij janë kryer një sërë veprimesh hetimore (vendime mbi vlerësime të kontrolleve të ngutshme për vlerësim sekuestro, mbi disponimin e sendeve si provë materiale, për marrje dokumentacioni dhe aktesh procedurale, për kryerje kontrolli banese, për vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi, për ekzekutim vendimi penal, për lejim dhe vlerësimin e përgjimit telefonik etj.).

Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika apo ndonjë shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje të hetuar, deri në momentin e zëvendësimit të tij si prokuror i çështjes penale nr. *** të vitit 2016.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

36. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv. Rastet dhe gjetjet e konstatuara lidhur me denoncimet, Komisioni nuk i konsideron të një problematike thelbësore, të cilat do të çonin në penalizimin e subjektit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Në përfundim të këtij vlerësimi subjekti i rivlerësimit konsiderohet “i aftë” dhe ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Arben Agovi ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arben Agovi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.12.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi